




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT


# DOKUMENTI I POLITIKAVE TË ARSIMIT TË LARTË



## Shkurt 2025

### Pasqyra e Lëndës

Lista e tabelave .....	3
Lista e figurave .....	3
1. Hyrje .....	4
1.1 Pse një dokument i politikave për arsimin e lartë .....	9
2. Kuadri i përgjithshëm .....	13
2.1 Prirjet e arsimit të lartë në Shqipëri .....	14
2.2 Kuadri i politikave .....	16
2.3 Kuadri institucional.....	19
2.4 Kuadri i sigurimit të cilësisë .....	22
2.5 Kuadri social .....	28
2.6 Kuadri i financimit.....	31
3. Arsimi i lartë shqiptar drejt 2030. Synimet dhe objektivat kryesore për të ardhmen .....	34
Objektivi strategjik I.1: Përmirësimi i ofertës akademike me synim fuqizimin e kapitalit njerëzor .....	36
Objektivi strategjik I. 2: Forcimi i lidhjeve me tregun e punës dhe profilizimi i universiteteve, bazuar në nevojat kombëtare dhe rajonale .....	43
Objektivi strategjik II.1: Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor nëpërmjet ndërkombëtarizimit, financimit të qëndrueshëm dhe inovacionit.....	46
Objektivi strategjik II.2: Fuqizimi i arsimit të lartë si katalizator i zhvillimit social, ekonomik dhe digjital drejt integritimit në BE .....	54
Referencat e përdorura.....	59




## Lista e tabelave

Tabela 1: Indeksi i zhvillimit të politikave sipas dimensioneve/fushave.....	17
Tabela 2: Buxheti i Arsimit të Lartë në Shqipëri .....	31
Tabela 3: Buxheti i Kërkimit Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri .....	31

## Lista e figurave

Figura 1: Buxheti në kërkim shkencor 2021-2024 .....	23
Figura 2: Kontributi BE për kërkimin shkencor në Shqipëri (milion euro).....	25
Figura 3: Studentë të regjistruar (2018-2023).....	30




## 1. Hyrje

Dokumenti i Politikave për Arsimin e Lartë 2030 shpreh përkushtimin drejt rritjes së cilësisë dhe përafrimit të standardeve të arsimit të lartë shqiptar me atë të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA) e Kërkimit Shkencor (ERA). Ai vjen si një nevojë për të avancuar në transformimin e arsimit të lartë bazuar në politikat aktuale të ndërmarra, me qëllim rritjen e cilësisë, aksesit dhe shanseve të barabarta në arsimin e lartë. Dokumentat strategjikë të miratuara nga Qeveria Shqiptare, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030; Strategjia Kombëtare e Arsimit 2026; Strategjia e Specializimit Inteligent 2030 (S3); Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor; Teknologjinë dhe Inovacionit 2030; orientojnë politika dhe masa konkrete në zhvillimet sektoriale, të arsimit, kërkimit shkencor, inovacionit, digjitalizimit, të fushave të ekonomisë dhe tregut të punës për të ecur me hapa të sigurt drejt integritit në Bashkimin Europian.

Ky Dokument politikash, përmban një analizë sintetike të arritjeve dhe sfidave me të cilat përballet arsimi i lartë duke shërbyer si një udhërrëfyes për hapat që do të ndiqen me qëllim konsolidimin dhe thellimin e reformës në arsimin e lartë, që nisi në vitin 2015 me kuadrin e ri të Ligjit 80\2015, duke vendosur bazat për standardet e cilësisë, integritetin akademik, transparencën dhe promovimin e zhvillimit social dhe ekonomik të vendit.

Si një udhërrëfyes që orienton hapat drejt rritjes së standardeve në arsimin e lartë, ai synon të nxisë shndërrimin e universiteteve tona në motorë të zhvillimit ekonomik dhe social, të fuqizojë më tej përmirësimin e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor dhe të inkurajojë e mbështesë ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë shqiptar.

Dokumenti i Politikave për Arsimin e Lartë 2030 u hartua me mbështetjen e ekspertëve të institucioneve të arsimit të lartë, ekspertëve ndërkombëtarë dhe u mbështet në analiza, raporte dhe reflektimet e nxjerra nga studime kombëtare dhe ndërkombëtare, vlerësime të indikatorëve të përfituar nga vëzhgimet e studentëve, trendet e zhvillimit të tregut të punës, aftësitë e lidhura me



kërkesat e kohës. Ky dokument është i hapur për përmirësime për t'u përshtatur dhe adaptuar me zhvillimet me të reja në arsimin e lartë, teknologji dhe inovacion dhe do të pasohet nga Plani i Veprimit për arritjen e qëllimeve të vendosura.

#### *Deklarata e vizionit për arsimin e lartë*


*Arsimi i lartë në Shqipëri të bëhet i njohur për ekselencën akademike, inovacionin, gjithëpërfshirjen dhe biznesin konkurrues. Institucionet e arsimit të lartë të sigurojnë gjithëpërfshirje të studentëve, komunitetit, shoqërisë dhe biznesit, veçanërisht duke u dhënë studentëve më shumë përkatësi dhe identitet përmes pajisjes me aftësitë e duhura, në mënyrë që të kontribuojnë brenda dhe jashtë vendit, drejt Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA) dhe Kërkimit Shkencor (ERA).*

*Arsimi i lartë të jetë nxitës i ideve të reja, përmes kërkimit shkencor, duke mundësuar shndërrimin e këtyre ideve në biznese të qëndrueshme dhe inovative të së ardhmes; të mbështesë ndryshimin përmes qasjeve inovative tek të mësuarit dhe mësimdhënies së mbështetur në kërkim shkencor cilësor; të përmirësojë metodat e vlerësimit të studentëve dhe të sigurojë një sistem të garantimit të cilësisë, duke ushqyer tregun me ide dhe inovacion.*

*Arsimi i lartë në Shqipëri të udhëhiqet nga ndërkombëtarizimi përmes profilizimit të ofertës akademike të orientuar drejt nevojave të tregut të punës në vend, por dhe në Evropë e më gjerë, duke u bërë edhe më tërheqës për studentët vendas, por dhe të huaj, me vëmendje më të madhe drejt një kërkimi shkencor cilësor që ka ndikim në nivel kombëtar, rajonal dhe në tregun global.*

Qëllimet kryesore për arsimin e lartë në këtë Dokument Politikash janë:

- Arsimi i lartë, faktor i rëndësishëm për zhvillimin e kapitalit njerëzor, social dhe ekonomik të vendit, përmes ofertës akademike bashkëkohore, në përputhje me nevojat e shoqërisë, kërkesat dinamike të tregut të punës, për të pajisur studentët me aftësitë e së ardhmes dhe duke synuar rritjen e produktivitetit. Rëndësi të veçantë oferta akademike do t'i kushtojë rritjes së cilësisë së studimeve shkencore në institucionet e arsimit të lartë, të cilat ndikojnë në zhvillimin e mëtejshëm ekonomik dhe social të vendit dhe shoqërisë shqiptare në tërësi, si qendër e rëndësishme rajonale për prioritetet e vendit.



- Zbatimi i reformave dhe politikave të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA) dhe Kërkimit Shkencor (ERA), përmes fuqizimit të mekanizmave të financimit, sigurimit të cilësisë, si dhe duke promovuar ndërkombëtarizimin dhe specializimin rajonal në përputhje me politikat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Edukimi është pasaporta më e mirë drejt së ardhmes në bashkësinë e madhe evropiane ku synojmë të anëtarësohemi shumë shpejt, ndërkohë që arsimit të lartë është një element kyç në këtë proces. Dokumenti i Politikave synon të përcaktojë drejtimet strategjike dhe masat konkrete për përmirësimin e cilësisë dhe pranimeve në arsimin e lartë, duke u mbështetur në standardet ndërkombëtare dhe nevojat specifike të vendit tonë.


Në qendër të këtij Dokumenti qëndron një pakt i fortë dhe i qëndrueshëm midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe të rinjve shqiptarë për të investuar në infrastrukturën e arsimit të lartë, duke përshtatur një qasje më të mirë ndaj:

1. teknologjisë;
2. zhvillimit të burimeve njerëzore;
3. zgjerimit të hapësirave të kërkimit shkencor cilësor.

Në të janë përfshirë gjithashtu angazhimet për:

1. integritet akademik;
2. transparencë;
3. llogaridhënie dhe përmirësimin e statusit socio-ekonomik të studentëve përmes ofrimit të shërbimeve cilësore e lehtësimin e barrës së tyre sociale e ekonomike, me synim zbutjen e diferencave sociale.

Përmes këtij Dokumenti Politikash që mbështetet mbi analiza të detajuara mbi të tashmen dhe hartimin e perspektivave për të ardhmen, shprehet bindja e plotë se investimi në arsimin e lartë është i vlefshëm, i sigurt dhe i qëndrueshëm.




Dokumenti i Politikave synon të sigurojë që arsimit të lartë në Shqipëri të jetë në harmoni me standardet ndërkombëtare, mbështetës i procesit të integritit evropian dhe faktor kyç për zhvillimin e vendit.

Përgjegjësia për të investuar në arsimin e lartë materializohet nëpërmjet mbështetjes financiare për zhvillimin e infrastrukturës dhe kërkimit shkencor; për ngritjen e kampuseve studentore, modernizimin e laboratorëve shkencorë, në përgjigje të zhvillimeve inovative e teknologjike dhe tërheqjen e ekselencës akademike për zhvillimin e mëtejshëm të kërkimit shkencor e cilësor në vend. Dokumenti synon të nxisë përfshirjen e kërkuesve dhe studentëve në programe ndërkombëtare. Veprimtaria kërkimore-shkencore synon rritjen e cilësisë së arsimit të lartë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm profesional e karrierës akademike.

Shqipëria ka bërë përparime të dukshme në sektorin e arsimit të lartë që nga reforma që filloi në vitin 2015, me Ligjin 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë". Për rrjedhojë është miratuar një kuadër i gjerë ligjor dhe institucional, që ashtu sikurse politikat aktuale, nxisin cilësinë, hyrjen në universitete dhe barazinë në arsimin e lartë; që përmbush standardet ndërkombëtare për cilësinë, integritetin akademik dhe transparencën në mënyrë që të nxisë zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.

Këtu përfshihen Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2023-2030, Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026, Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023–2030, Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2023-2030, Agjenda Digjitale Shqiptare 2015-2020, Plani Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale 2020-2025, Pakti për Universitetin, Strategjia e Specializimit Inteligent (S3) 2024 - 2030.

Mjedisi institucional është i favorshëm për zbatimin e reformës dhe zhvillimin e arsimit të lartë, duke patur parasysh se janë krijuar një sërë agjencish të veçanta për të zbatuar ligjet dhe politikat në këtë sektor. Në këtë kuadër mund të përmendet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), Agjencia Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin (AKKSHI) që u krijua në vitin 2016, pasuar në vitin 2017 nga krijimi i Agjencisë Kombëtare për Financimin e




Arsimit të Lartë (AKFAL). Përveç kësaj u ndërmor hartimi i Kuadrit Shqiptar të Kualifikimeve (KSHK), që u realizua në përputhje me atë evropian. Si rrjedhojë, zbatimi i kuadrit ligjor dhe institucional, së bashku me përparimet në sigurimin e cilësisë, janë shoqëruar me një rritje të shpejtë të arsimit të lartë.

Qëllimi i këtij Dokumenti Politikash është që të japë një panoramë sa më të plotë të arsimit të lartë në Shqipëri, ku përfshihen arritjet dhe sfidat e këtij sektori. Mbështetur mbi këtë analizë paraprake do të përcaktohen drejtimitet e politikave prioritare për arsimin e lartë deri në 2030, që do të synojnë zhvillimin dhe rritjen e mëtejshme të cilësisë së tij.

Objektivat e arsimit të lartë në Shqipëri janë të orientuara drejt përmirësimit të cilësisë, rritjes së mundësisë për të ndjekur arsimin e lartë, gjithëpërfshirjes si dhe lidhjes më të mirë me tregun e punës dhe kërkimin shkencor. Këto objektiva janë të përcaktuara në mënyrë që arsimi i lartë në vend të jetë konkurrues edhe në nivel ndërkombëtar, i lidhur ngushtë me nevojat e shoqërisë dhe ekonomisë. Realizimi i këtyre objektivave kërkon një angazhim të plotë nga të gjitha palët e interesuara, përfshirë qeverinë, institucionet arsimore, studentët, dhe sektorin privat.

Dokumenti i Politikave reflekton edhe angazhimet e ndërmarra në Deklaratën e Ministerialit të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA) në Tiranë, të 30 majit 2024, si një mbështetje në ofrimin e përvojës më të mirë dhe lehtësimin e mobilitetit të stafeve pedagogjike dhe studentëve. Në këtë mënyrë zgjerohen hapësirat që ata të thellojnë studimet, kërkimin, formimin e tyre profesional dhe shkëmbimin e eksperiencave në universitete simotra të Evropës dhe më gjerë.

Duke pranuar si sfidën tonë të përbashkët transformimin e Shqipërisë në të ardhmen, në një qendër ekselence në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit në rajonin e Ballkanit Perëndimor, Dokumenti i Politikave synon të udhëheqë reformat në arsimin e lartë në Shqipëri në këtë drejtim. Ai synon ta bëjë këtë duke siguruar një sistem arsimor universitar me cilësi të lartë, hapësirë për bashkëpunim të shumanshëm dhe gjithëpërfshirës. Zbatimi i këtyre politikave do të ndihmojë në krijimin e një sistemi cilësor dhe konkurrues në nivel ndërkombëtar.






## 1.1 Pse një dokument i politikave për arsimin e lartë

Në vitin 2021 u hartua Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026, duke vendosur një bazë të fortë për cilësinë e arsimit, rritjen e aksesit dhe gjithpërfshirjen, si dhe një lidhje më të ngushtë me tregun e punës dhe kërkimin shkencor. Në këtë rrugëtim, Shqipëria ka përjetuar arritje të rëndësishme, por edhe pengesa.

Në qendër të Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 qëndron arsimi i lartë gjithpërfshirës, që plotëson standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës, dhe është nxitës i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit. Nëpërmjet objektivave të kësaj strategjie synohet:

- Rritja e cilësisë së arsimit të lartë nëpërmjet riorganizimit të programeve të studimit, modernizimit të infrastrukturës akademike dhe zbatimit të standardeve të larta të vlerësimit institucional dhe të programeve të studimit;
- Nxitja e përsosmërisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor;
- Ndërlidhja më e mirë e arsimit të lartë me tregun e punës;
- Sigurimi i integritetit akademik, transparencës dhe llogaridhënies në sektorin e arsimit të lartë;
- Përmirësimi i statusit socio-ekonomik të studentëve nëpërmjet ofrimit të shërbimeve cilësore dhe formave të ndryshme të ndihmës financiare;
- Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë në Shqipëri dhe integrimi në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA);
- Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) dhe i shërbimeve digjitale për IAL-të publike.


Sigurisht që kjo strategji i ka dhënë një shtysë pozitive arsimit të lartë në Shqipëri, por konteksti kombëtar dhe ai ndërkombëtar vazhdon të evoluojë dhe është e nevojshme që këto ndryshime të reflektohen në mënyrë të vazhdueshme, dhe rruga që shtrihet përpara mbetet akoma e gjatë dhe ka nevojë për ndërhyrje dhe iniciativa të vazhdueshme. Megjithatë, mbështetur në procesin e



monitorimit që i është bërë zbatimit të Strategjisë, vihen re përmirësime të dukshme në këtë sektor.

Kështu, lidhur me përmirësimin e kapacitetit të personelit akademik në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, janë rritur në mënyrë të ndjeshme fondet e vëna në dispozicion për kërkim shkencor dhe infrastrukturë, nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI). Vetëm në 4 vitet e fundit, fondi për infrastrukturën e kërkimit shkencor është rritur me 75%, ndërkohë që fondi për kërkim shkencor është 5-fishuar. Nga ana tjetër, trajnimet për stafin e ri akademik janë gjithashtu një aspekt i rëndësishëm që raportohet se janë rritur nga pothuajse të gjithë IAL-të në Shqipëri nëpërmjet burimeve të tyre të brendshme, por edhe nëpërmjet projekteve të ndryshme që IAL-të kanë. Shtimi i ndjeshëm i projekteve të përfituara në kuadër të Programit Erasmus+ (2021-2027) nga të gjitha IAL-të ka ndikuar pozitivisht në këtë aspekt, ku vlen të theksohet angazhimi i lektorëve shqiptarë në universitetet e ndryshme evropiane në kuadër të këtyre marrëveshjeve. Një rritje të ndjeshme kanë patur dhe aplikimet dhe pjesëmarrjet në projekte Erasmus CBHE, ku IAL-të shqiptarë kanë qenë shumë aktive dhe kanë përfituar nga këto projekte në terma të rritjes së kapaciteteve. Këto arritje pozitive përforcohen edhe nga gjetjet e Raportit të Bordit të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë (2024), që ka bërë një vlerësim sasior të cilësisë së arsimit të lartë. Raporti konkludon se midis 2016 dhe 2023 ka pasur një rritje të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë, në bazë të treguesve të cilësisë së përdorur.

Sa i përket ndërlidhjes më të mirë të arsimit të lartë me tregun e punës, megjithëse IAL-të raportojnë se punohet fort në këtë drejtim, sërish ka ende për të bërë. Nisma mjaft të mira në këtë drejtim janë marrë për hapjen e programeve profesionale 2-vjeçare, të cilat përfshijnë jo vetëm të rinj që nuk arrijnë nivelin e kërkuar të mesatares për të ndjekur studimet në nivel bachelor, por gjithashtu i orientojnë të rinjtë më mirë drejt tregut të punës. Rritja e mundësive për punë praktike gjatë studimeve universitare është gjithashtu një moment i rëndësishëm, por megjithëse janë ngritur e funksionojnë Zyrat e Karrierës në çdo IAL, sërish lidhja e studentëve me tregun e punës ka nevojë për përmirësime.




Pasurimi dhe përmirësimi i shërbimeve për studentët ka ecur me hapa të sigurt, ku mbështetja financiare që i jepet studentëve përbën një nga elementet më të rëndësishme. Në këtë kuadër janë realizuar programe të veçanta për mbështetjen e studentëve nga shtresat e marginalizuara. Ndërkohë, zhvillimi i skemave të ndihmës financiare dhe bursave kanë mundësuar që më shumë të rinj nga të gjitha shtresat social-ekonomike të ndiqnin ëndrrat e tyre për të vazhduar studimet universitare. Vlen të përmendim këtu bursat që marrin studentët e shkëlqyer, ata që i përkasin kategorive të veçanta social-ekonomike dhe bursat që marrin studentët e degëve prioritare, ku mbi 50,000 studentë janë përfitues.

Përmirësimi i cilësisë së arsimit është një nga prioritetet kryesore. Përmes zbatimit të kurrikulave të përmirësuara dhe trajnimeve intensive për pedagogët, universitetet shqiptare kanë arritur standarde të reja akademike. Nga ana tjetër, proceset e akreditimit dhe monitorimit zhvilluan standartet akademike, duke krijuar një mjedis arsimor universitar më të mirë dhe të besueshëm.


Në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit, Shqipëria ka njohur një zhvillim të dukshëm dhe një ringjallje të interesit të stafëve akademike për t'u përfshirë sa më shumë në projekte të tilla. Investimet për financimin e projekteve kërkimore u rritën, duke krijuar mundësi të reja për studentët dhe stafin akademik. Një element i rëndësishëm në këtë drejtim ka qenë krijimi i qendrave të inovacionit dhe inkubatorëve të biznesit, duke inkurajuar sipërmarrjen dhe krijimin e ideve të reja.

Ndërkohë, universitetet shqiptare kanë përmirësuar e thelluar një bashkëpunim më të ngushtë me sektorin privat për të ofruar praktika profesionale dhe mundësi punësimi për studentët. Në përpjekjen për të lidhur arsimin me tregun e punës, përshtatja e programeve akademike me ndryshimet e shpejta të tij është një sfidë e vazhdueshme. Në këtë drejtim duhet theksuar se mundësitë e pamjaftueshme për praktika profesionale nga ana e të gjithë studentëve të interesuar ka qenë një pengesë, e cila ka patur ndikimin e saj në procesin e formimit profesional.

Një sfidë tjetër ka qenë edhe përmirësimi i infrastrukturës teknologjike në Institucionet e Arsimit të Lartë. Ndërkohë që disa institucione përfituan nga infrastruktura teknologjike moderne, të



tjerat shpesh u përballën me mungesë të saj, duke pamundësuar integrimin e teknologjisë në procesin mësimor. Aftësitë digjitale të stafit akademik dhe studentëve gjithashtu ishin të kufizuara, duke ngadalësuar përdorimin efektiv të teknologjisë.




## 2. Kuadri i përgjithshëm

Kjo pjesë e Dokumentit do të argumentojë ndërhyrjet në themel të proceseve të kuadrit ligjor, që do të ndërmerren në këtë sektor. Në këtë mënyrë krijohet një siguri që ato të jenë të planifikuara, sistemike, të balancuara dhe të qëndrueshme dhe jo një përgjigje e thjeshtë ndaj sfidave që sjell tregu i lirë në zhvillimin e arsimit të lartë. Gjithashtu, kjo pjesë e dokumentit analizon aspekte të lidhjes së arsimit të lartë dhe shoqërisë, në mënyrë që të projektohen rrugët sesi duhet të ndryshojë sektori në të ardhmen, që të përballojë sfidat e reja ekonomike, sociale dhe kulturore të shoqërisë shqiptare. Ky Dokument Politikash është hartuar duke patur parasysh një sërë sfidash në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, me të cilat po përballet arsimi i lartë. Për të realizuar rolin që ka në shoqëri, sektori duhet të sigurojë cilësinë dhe lidhjen më të mirë me nevojat e saj dhe ekonomisë shqiptare, ndërkohë që vepron në një mjedis të globalizuar dhe gjithnjë e më konkurrues.

Sistemi i arsimit të lartë në Shqipëri ka bërë progres të rëndësishëm në fusha të ndryshme si: mundësitë e zgjeruara të të mësuarit; larmia e bazës institucionale; rritja e financimit nga buxheti i shtetit dhe burimeve të ndryshme; pajtueshmëria me Deklaratën e Bolonjës nëpërmjet miratimit të një kuadri të përbashkët për diploma cilësore dhe të krahasueshme në nivel universitar dhe pasuniversitar; akreditimi i programeve dhe institucioneve; vizioni i ri për kërkimin shkencor nëpërmjet Strategjisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe riorganizimi e menaxhimi i arsimit të lartë.

Duke pasur parasysh progresin e mësipërm, në këtë analizë, krahas paraqitjes së pikave të forta që e kanë sjellë këtë sektor deri këtu, do të parashtrohen edhe vështirësitë, sfidat, burimet njerëzore e financiare për të arritur rezultate e për të ndërtuar politika të qarta që do t'i shërbejnë arsimit të lartë gjatë viteve të ardhshme.

Analiza është mbështetur në studimet e realizuara për arsimin e lartë në Shqipëri nga Banka Botërore, OECD, nga Raporti i Bordit të Akreditimit për ecurinë e arsimit të lartë në Shqipëri 2016-2023, si edhe në të dhënat statistikore dhe administrative të siguruar nga institucionet




kombëtare dhe ndërkombëtare si EUROSTAT, INSTAT, MAS etj. Kjo analizë përfshin elemente të tilla si: mënyra e funksionimit të arsimit të lartë, treguesit sasiorë të Institucioneve të Arsimit të Lartë (si psh. numrin e studentëve e programeve të studimit), treguesit cilësorë të institucioneve dhe programeve të tyre të studimit, kuadrin ligjor e institucional që garanton funksionimin e këtij sistemi si dhe politikat e ndjekura për të nxitur garantimin e cilësisë në mësimdhënie, kërkim shkencor e ndërkombëtarizim.

## 2.1 Prirjet e arsimit të lartë në Shqipëri

Në vitin 2015, Ministria e Arsimit dhe Sportit ndërmori një reformë në sektorin e arsimit të lartë, e cila përreth një dekade çoi në ndryshimin e mekanizmave institucionalë që garantonin arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Shqipëri. Si rezultat i kësaj reforme, arsimi u zhvillua duke krijuar një kuadër ligjor bashkëkohor, sipas modeleve më të përparuara, duke e bërë arsimin e lartë shqiptar autonom, më konkurrues, më të hapur dhe më të lidhur me ekonominë dhe tregun e punës.

Periodha pas pandemisë së COVID-19 ishte kohë e ndryshimeve të shpejta për arsimin e lartë. Në qendër të ndryshimeve u vendos digjitalizimi dhe integrimi i modeleve të mbështetura në sistemet online të mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke ndryshuar rrënjësisht paradigmen tradicionale të mësimdhënies, të nxënies dhe menaxhimit të IAL. Në këtë kuadër, ndikimi i digjitalizimit në arsimin e lartë mund të përdoret në kategoritë e mëposhtme:


- Përdorimi institucional, duke përfshirë marketingun dhe pranimin e studentëve.
- Krijimin e disiplinave të reja për rrjedhojë edhe njohurive të reja si brenda disiplinave individuale ashtu edhe në ato ndërdisiplinore.
- Krijimin e mundësisë për përdorimin e platformave me të dhëna të hapura.
- Kërkime shkencore ndërdisiplinore, ku inteligjenca artificiale përdoret si një instrument ndihmës e mbështetës.



Ndërkohë duhet theksuar se sektori i arsimit të lartë po përballlet prej disa vitesh me një ndryshim të shifrave të regjistrimit të studentëve në arsimin e lartë. Regjistrimet në IAL kanë rënë gradualisht përgjatë pesë viteve të fundit dhe janë ulur gjatë pandemisë COVID-19 e më pas. Por veçanërisht, rënia e nivelit të lindjeve pas vitit 2008, ka të ngjarë të ndikojë në regjistrimin në universitete, duke filluar nga viti 2025 dhe duke arritur pikën më të lartë në vitet 2030. Gjithashtu, migrimi ndërkombëtar i studentëve pas vitit 2012 njihet si një faktor i rëndësishëm i uljes së numrit të studentëve të regjistruar në IAL-të shqiptare. Nga ana tjetër, rënia e numrit të studentëve që regjistrohen në universitetet është shoqëruar me një rritje të lehtë të numrit të studentëve ndërkombëtarë që studiojnë në universitetet shqiptare. Megjithatë, numri në rritje i regjistrimeve të studentëve ndërkombëtarë nuk mund të mbulojë hendekun e krijuar.

Të diplomuarit në sistemin e arsimit të lartë shqiptar kanë qenë dhe do të jenë faktorë kritikë për zhvillimin e industrisë, teknologjisë dhe shërbimeve cilësore. Në të njëjtën kohë ata janë parësorë për tërheqjen e investimeve të huaja në vend, duke ndikuar në rritjen ekonomike, krijimin e vendeve të punës me aftësi të larta e të mirëpaguara si edhe një standard më të lartë të nivelit të jetesës. Shkalla e investimeve në kërkimin shkencor është zgjeruar në mënyrë të konsiderueshme, ndërkohë që cilësia dhe niveli i kërkuesve shqiptarë ka tashmë ndikim edhe në nivel ndërkombëtar. Vetëm nëse krahasojmë vitet e fundit, nga viti 2021 deri në 2024 fondi për kërkim shkencor është rritur me 5 herë, ndërkohë që fondi për infrastrukturë në kërkim shkencor është dyfishuar. Studimet tregojnë se të diplomuarit shqiptarë janë ndër më të punësuarit në Evropë e më tej, në raport me numrin e popullsisë. Gjithashtu, niveli i punësimit të studentëve shqiptarë në Evropë është në shkallë të krahasueshme me studentët e vendeve pritëse.

Shqipëria është angazhuar për pjesmarrjen e saj efektive në procesin e integritit evropian, për ta bërë arsimin e lartë pjesë të Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA) dhe kërkimin shkencor, pjesë të Zonës Evropiane të Kërkimit (ERA), përmes përmirësimit të politikave, kuadrit institucional dhe standardeve të cilësisë në arsim. Në këtë drejtim, ndërkombëtarizimi ka qenë prioritet në agjendat e universiteteve shqiptare. Një aspekt i rëndësishëm që lind nga investimi në fushën e ndërkombëtarizimit është zhvillimi i aftësive të studentëve për të konkurruar në një treg



global. Duhet theksuar se procesi i ndërkombëtarizimit ka rezultuar në marrëveshje bashkëpunimi mes universiteteve shqiptare me ato të vendeve të BE-së, nëpërmjet programeve të mobilitetit dhe shkëmbimit të përvojave akademike, duke kulmuar me hartimin e programeve të përbashkëta të studimit (joint degree) ose diploma të dyfishta (dual degree), ku vetëm në vitin e fundit janë realizuar 12 të tilla.

## 2.2 Kuadri i politikave

Dokumenti i Politikave të Arsimit të Lartë 2030 është mbështetur në kuadrin politik, ligjor institucional dhe strategjik që ekziston aktualisht. Si rrjedhojë, gjatë hartimit të Dokumentit janë marrë parasysh një sërë strategjish ndërsektoriale që ndërlidhen me arsimin e lartë si: Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022–2030, Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, Strategjia Kombëtare për Kërkim Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023-2030, Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026, Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2023-2030, Agjenda Digjitale Shqiptare 2015-2020, por rëndësi të veçantë kanë pasur edhe studimet mbi situatën aktuale të arsimit të lartë në Shqipëri, si Raporti i Bordit të Akreditimit të Arsimit të Lartë (2024), i Bankës Botërore etj.

Po ashtu, Dokumenti ndjek frymën e Paktit për Universitetin (2018), një deklaratë politike e paraqitur nga qeveria shqiptare në përgjigje të kërkesave të studentëve për kushte më të mira studimi, përmirësime të cilësisë, integritetit akademik, transparencës dhe përgjegjshmërisë në arsimin e lartë. Nga raportet kombëtare, siç u përmend më lart, një raport i rëndësishëm i kryer për herë të parë në Shqipëri është ai i Bordit të Akreditimit (2024), i cili ka studiuar nivelin e cilësisë të IAL-ve dhe programeve të tyre të studimit, të vlerësuar për periudhën 2016-2023. Ky raport përveç arritjeve të IAL-ve gjatë viteve të fundit, ka gjetur edhe një sërë sfidash të rëndësishme, dhe ka bërë rekomandime për adresimin e tyre, çka do t'i jepte një hov më të shpejtë zhvillimit të arsimit të lartë në vend.





Ndërkohë, Ligji Nr 80/2015 datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor” dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të tij kanë synuar të krijojnë një kuadër ligjor garantues për një sistem gjithëpërfshirës të arsimit të lartë, që përmbush standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik dhe transparencës, duke nxitur zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.


Në nivel të sektorit, institucionet e arsimit të lartë në partneritet me qeverinë, biznesin dhe mbarë shoqërinë synojnë të jenë faktorë kyç për zhvillim. Ndryshimet e vazhdueshme që kanë ndodhur pas reformës së vitit 2015 kanë treguar se zhvillimi i arsimit të lartë ka qenë i pranishëm përgjatë viteve. Kështu, raporti i OECD “Konkurueshmëria e Ballkanit Perëndimor për vitin 2024” (Competitiveness Outlook 2024) ofron një nga vlerësimet më gjithëpërfshirëse të reformave ekonomike në rajon, referuar 15 dimensioneve (fushave) të politikave në 6 vendet e Ballkanit Perëndimor (6BP). Në këtë raport tregohet se Shqipëria ka një progres të theksuar në të gjitha dimensionet, krahasuar me të dhënat e të njëjtit raport në 2021, ndër të tjera edhe në arsim, shkencë dhe inovacion. Si rrjedhojë, Shqipëria rezulton ndjeshëm mbi mesataren e 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor për dimensionin e politikave arsimore dhe është në të njëjtin nivel për politikat në fushën e shkencës dhe teknologjisë.

Tabela 1: Indeksi i zhvillimit të politikave sipas dimensioneve/fushave

Dimensioni	Rezultatet 2021	Rezultatet 2024	Mesatarja e 6BP
Politika arsimore	3.3	3.6	2.9
Shkenca, teknologjia, inovacioni	1.8	2.4	2.4

Burimi: *Competitiveness Outlook 2024 (Shkalla 1-4)*

Gjithashtu, raporti i Bordit të Akreditimit (2024) ka evidentuar se gjatë periudhës 2017-2023 ka pasur një përmirësim të universiteteve të vlerësuar, në lidhje me laboratorët dhe infrastrukturën, ndërkombëtarizimin, tregun e punës, punësimin dhe mbështetjen e studentëve.



## Sfidat


Me gjithë progresin, raportet ndërkombëtare vërejnë se pavarësisht arritjeve të reformave të paraqitura në politikat kombëtare, ato nuk janë pasqyruar siç duhet në planet strategjike të IAL-ve. Megjithëse këto politika reformuese kanë vendosur objektiva të qarta strategjike për përballimin e problematikave kryesore me të cilat përballet vendi, zbatimi i tyre nga IAL-të, ka qenë një sfidë.

Edhe pse aksesin në mjetet digjitale është rritur, përdorimi i TIK-ut në universitete mbetet ende një sfidë, siç dëshmohet nga faqet web të IAL-ve, të cilat përmbajnë informacion të paktë, gjë që krijon mangësi në procesin e vlerësimeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Shërbimet digjitale për studentët janë përmirësuar, përmendim këtu regjistrimin në universitete, garantimin e transparencës në proceset e pranimit, por ende mbetet shumë për të bërë nga vetë universitetet për të fuqizuar shërbimet digjitale për studentët.

Sondazhi i fundit i studentëve në 2022, ku morën pjesë të gjitha IAL-të, ka treguar se qasja në laboratorët digjitalë në universitete duhet të rritet, ndërsa kompanitë e TIK-ut e konsiderojnë numrin e paktë të të diplomuarve me aftësi digjitale të avancuara, si një pengesë për rritjen e tyre. Në të njëjtën kohë qeveria ka ndërmarrë disa hapa për të rritur qasjen e studentëve ndaj platformave digjitale që janë në dobi të formimit të tyre, duke rritur investimet në laboratorë të kërkimit shkencor në universitete.

Edhe pse në vitet e fundit është rritur numri i programeve të akredituara, ofrimi i degëve të studimit në gjuhë të huaj, numri i programeve të përbashkëta dhe diplomave dyfishe, mbetet ende sfidë rritja e numrit të studentët e huaj.

Mbështetja financiare e qëndrueshme për përsosmërinë e stafëve akademike, kërkimin shkencor, programet e shkëmbimeve janë thelbësore në drejtim të rritjes së interesit në programet e studimit të universiteteve shqiptare, ashtu sikurse programet e studimit në distancë dhe përfshirja e diasporës akademike dhe stafëve akademike ndërkombëtare mund të nxisin më tej interesin për të studiuar në Shqipëri.




## 2.3 Kuadri institucional

Në Shqipëri aktualisht ushtrojnë veprimtarinë e tyre 40 Institucione të Arsimit të Lartë – IAL (14 publike dhe 26 private), ku 6 prej tyre ndodhen në qytetet e Durrësit, Elbasanit, Shkodrës, Gjirokastrës, Vlorës e Korçës. Aktiviteti i tyre rregullohet nëpërmjet Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë”, si edhe një sërë aktesh nënligjore dhe rregulloresh të tyre të brendshme në bazë të parimit të autonomisë akademike. Nisur nga numri total i IAL-ve në RSH, rezulton se Shqipëria ka 15 IAL për përafërsisht 1 milion banorë, duke qenë një raport më i lartë edhe se në vendet e BE, që e kanë këtë tregues 7 IAL për 1 milion banorë.

Në vitin 2014, në kuadër të reformës për cilësinë e arsimit të lartë e kërkimit shkencor që u ndërмор nga qeveria shqiptare, 18 institucione private të arsimit të lartë dhe një institucion publik që nuk plotësonin kriteret, u mbyllën. Aktualisht Shqipëria ka rreth 900 studentë për 100,000 banorë, ndërkohë që raporti i regjistrimit të nxënësve në arsimin e lartë është 58.8%.

Ministria e Arsimit dhe Sportit mbikqyr politikëbërjen e përgjithshme në sistemin arsimor në vend, ndërsa institucione të tjera në varësi të MAS janë përgjegjëse për aspekte specifike të sektorit. Në këtë kuadër, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL) është përgjegjëse për dhënien e fondeve të buxhetit të shtetit për IAL-të publike dhe ofrimin e bursave për studentët e shkëlqyer, ata të shtresave të pambrojtura e të marginalizuara, si edhe studentët e regjistruar në programet kombëtare prioritare, ku aktualisht mbështeten me bursa rreth 50,000 studentë.

Një prej agjencive të tjera është Agjencia për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), e cila ka përgjegjësinë për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e cilësisë së arsimit të lartë në Shqipëri nëpërmjet mekanizmave të sigurimit të cilësisë dhe proceseve të akreditimit. Aktiviteti i Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) mbështetet në Kodin e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, që përcakton standardet shtetërore të sigurimit të




cilësisë, të cilat janë të detyrueshme për IAL-të. Ndërkohë, Agjencia Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin (AKKSHI) është përgjegjëse për nxitjen e kërkimit shkencor dhe inovacionit, duke mbështetur, monitoruar dhe vlerësuar programet dhe projektet në fushën e kërkimit shkencor. Gjithashtu AKKSHI administron dhe përditëson bazën kombëtare të të dhënave në këtë drejtim.

Në bazë të funksioneve e përgjegjësi të sipërpërmendura, financimi i mësimdhënies dhe kërkimit shkencor me fonde publike në IAL realizohet nëpërmjet dy agjencive kryesore. Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL), që shpërndan çdo vit akademik Grantin e mësimdhënies dhe Grantin institucional për të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë, dhe Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor e Inovacionit (AKKSHI), që ofron Grantin e kërkimit shkencor, mbi baza konkurruese për të gjitha IAL-të publike e jopublike.

Duhet theksuar se reforma për arsimin e lartë që u zhvillua përgjatë vitit 2014 u pasua me miratimin e Ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", i cili vendos kornizën kryesore ligjore për arsimin e lartë shqiptar. Reforma u mbështet në modelet dhe praktikat më të mira të vendeve të zhvilluara të BE-së. Ligji vendosi bazën për një autonomi më të madhe financiare dhe liri akademike për IAL-të në Shqipëri, duke unifikuar dhe standardizuar në të njëjtën kohë edhe sistemin e arsimit të lartë. Njëkohësisht ai bëri të mundur rritjen e konkurrencës midis IAL-ve dhe zhvillimin e lidhjeve organike midis programeve të arsimit të lartë dhe nevojave të tregut të punës.

Ligji 80/2015 u bë pjesë e një kuadri ligjor gjithëpërfshirës, i përbërë nga një sërë aktesh nënligjore që mbulojnë të gjitha aspektet e arsimit të lartë në vend, duke përfshirë elemente të tilla si, sigurimi i cilësisë, ngritja e institucioneve për të mbikëqyrur arsimin e lartë, financimi i IAL-ve, hapja e IAL-ve të reja, hapja, mbyllja dhe riorganizimi i programeve të studimit, kriteret për marrjen e titujve akademikë, vlerësimi i institucioneve të arsimit të lartë dhe aspekte të tjera të etikës dhe integritetit akademik.




## Sfidat

Institucionet që janë të lidhura me financimin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor dhe që sigurojnë cilësinë e arsimit të lartë kanë ende nevojë të fuqizohen në proceset e funksionimit të tyre të brendshëm, duke përfshirë sistemin e menaxhimit dhe ato të matjes së performancës së tyre. Nga ana tjetër duhet theksuar se kapacitetet njerëzore duhet të rriten përmes trajnimit të vazhdueshëm në lidhje me aftësitë, që kanë të bëjnë me menaxhimin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. Identifikimi, përzgjedhja dhe kryerja e rregullt e trajnimeve, përfshirë pjesëmarrjen në aktivitete ndërkombëtare sipas nevojave të stafit, duhet të jenë pjesë e strategjive të institucioneve. Gjithashtu, një fokus i veçantë duhet dhënë nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) për trajnime që duhet të jenë të përshtatura me nevojat specifike të këtyre agjencive.

Ligji 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” filloi zbatimin në një mjedis kontestimesh. Për këtë arsye, pas 10 vitesh jetë është e domosdoshme një analizë e thelluar për aspekte të ndryshme të zbatimit të tij si dhe ndikimi i ligjit në ndryshimin e sistemit të arsimit të lartë në Shqipëri, duke u fokusuar tek financimi mbi bazën e performancës së universiteteve dhe investimet direkte në profilizimin e tyre, duke u fokusuar në qasjet e zhvillimit rajonal.

Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026 planifikon zhvillimin e një pakete programesh që përfshin inovacionin dhe përsosmërinë në prodhimin e teknologjisë së informacionit. Kjo paketë do të ofrojë kualifikime në inovacion, dizajn marketingu, kërkim dhe zhvillim. Sfida mbetet tek universitetet për të nxitur kurset e Nivelit 5 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (cikli i shkurtër), për shkak të kërkesës së ulët si nga punëdhënësit ashtu edhe nga studentët.




## 2.4 Kuadri i sigurimit të cilësisë

Fushat e përgjithshme të studimit në Shqipëri kanë një shpërndarje të ngjashme me atë të të diplomuarve në vendet e BE-së. Fushat në të cilat janë diplomuar më shumë studente femra në vitin 2023, janë “arsim”, ku ato zënë 81.4%, ndjekur nga “shëndet dhe mirëqenie” me 79.1 %, ndërsa “arte dhe shkenca humane” me 78.2 %. Ndërkohë, fushat e studimit, në të cilat janë diplomuar më shumë studentët meshkuj janë “shërbimet” me 73.6 %, “inxhinieri, prodhim e ndërtim” me 62.6 % dhe “bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinar” me 55.1%. Ndërkaq, interesimi për programet STEM (shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë) është në rritje të vazhdueshme. Psh., që në vitin akademik 2019-2020, ishin 27.3% të studentëve, që vijonin programe në shkenca natyrore, matematikë dhe statistikë; teknologji informacioni dhe komunikimit; si dhe inxhinieri, prodhim dhe ndërtim dhe ky trend ka vijuar.

Një nga elementet kryesore të institucioneve të arsimit të lartë, që garanton cilësinë e mësimdhënies akademike e të kërkimit shkencor, është stafi akademik e ndihmësakademik. Në vitin akademik 2022-2023, personeli mësimor efektiv në IAL-të shqiptare përbëhej nga 4,844 pedagogë ose një pedagog për 28.7 studentë.

Një nga elementet e cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë është ndërkombëtarizimi dhe ndërveprimi me Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA) dhe Zonën Evropiane të Kërkimit Shkencor (ERA). Aktualisht IAL-të në Shqipëri, përsa i përket ndërkombëtarizimit, përveç marrëveshjeve dypalëshe të bashkëpunimit, po shfrytëzojnë edhe programe të tilla si Erasmus, CEEPUS, Fulbright etj. Legjislacioni në fuqi për njohjen dhe ekuivalentimin e gradave e titujve shkencorë është një mundësi për të rritur mobilitetin akademik dhe përforcuar më tej dimensionin ndërkombëtar të arsimit të lartë.

Programet dhe diplomat e përbashkëta dhe/ose të dyfishta të studimit “double & joint degree” mbeten mundësi shumë të mira për ndërkombëtarizimin dhe rritjen e cilësisë së arsimit të lartë në




Shqipëri, përballë globalizimit ekonomik e demografik që po përfshin të gjitha vendet. Shumë prej IAL-ve shqiptare, publike dhe private kanë filluar tashmë të ofrojnë diploma të tilla.

Duhet theksuar se zhvillimi i kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit konsiderohet një politikë horizontale sepse zbatimi i tij ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin social-ekonomik të vendit. Strategjia Kombëtare e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacioni 2023-2030 është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI).

“Pakti për Universitetin” në vitin 2018 shënoi një pikë kthese sa i takon zhvillimit të kërkimit shkencor në universitete. Në këtë drejtim ka një përparim të konsiderueshëm në disa tregues të zhvillimit të kërkimit shkencor, si në numrin e studiuesve të përfshirë në aktivitete kërkimore ashtu edhe në buxhetin e dhënë për kërkimin shkencor në IAL-të.


Figura 1: Buxheti në kërkim shkencor 2021-2024



Burimi: AKKSHI 2024

Duket qartë që buxheti i kërkimit shkencor në katër vitet e fundit ka pasur një rritje të ndjeshme. Kështu, fondi i kërkimit shkencor nga viti 2021, në vitin 2024 është 5-fishuar, ndërkohë që fondi i infrastrukturës së kërkimit shkencor pothuajse është 2-fishuar.

Tipet e programeve të financuara kanë pësuar një zgjerim të vazhdueshëm, duke filluar nga viti 2019, ku programet e kërkimit shkencor përbëheshin vetëm nga Projekte Kombëtare të Kërkimit



dhe të Zhvillimit + Infrastrukturë dhe Bilaterale, sot këto programe janë zgjeruar dhe kanë marrë një pamje më të plotë, ku përfshihen: Projekte Kombëtare të Kërkimit dhe të Zhvillimit, Infrastrukturë, Projektet e Teknologjisë dhe Inovacionit, Bilaterale dhe EUREKA.

Institucionet e arsimit të lartë po përgatiten t'i nënshtrohen vlerësimit të kërkimit shkencor në njësitë e tyre bazë (departamentet), ashtu sikurse edhe revistat e tyre shkencore do të jenë pjesë e një klasifikimi në nivel kombëtar. Përafrimi i objektivave kombëtare të kërkimit shkencor, inovacionit dhe teknologjisë me ato të Zonës Evropiane të Kërkimit Shkencor (ERA) janë për Shqipërinë një garanci për cilësinë dhe infrastrukturën e kërkimit, lëvizshmërinë e studiuesve, bashkëpunimet ndërkombëtare dhe ndërgjegjësimin e publikut për rolin e shkencës në shoqëri.

Një rol shumë i rëndësishëm po i jepet diasporës akademike. Tërheqja e diasporës së shquar akademike, do të jetë një garanci për arritjen e këtyre objektivave në mënyrë sa më të shpejtë dhe efektive.

Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023-2030 ka përcaktuar prioritetet dhe objektivat kryesore për konsolidimin e mëtejshëm të reformës në arsim dhe kërkimin shkencor, duke i harmonizuar ato me parimet e Zonës Evropiane të Kërkimit. Në këtë kuadër, Ligji “Për Shkencën dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë” është hartuar dhe miratuar në qeveri si dhe në Kuvendin e Shqipërisë.

Është rritur pjesëmarrja në Programet Kuadër të BE-së për Kërkimin Shkencor e Inovacionin, siç është Horizon Europe, përkundrejt programeve të mëparshme, sa i përket numrit të institucioneve shqiptare pjesëmarrëse, projekteve të financuara, fondeve të përfituara dhe nivelin e suksesit. Gjithashtu, në vitin 2018 Shqipëria u bë anëtare e plotë e Shoqatës për Bashkëpunimin Shkencor e Teknologjik (COST) dhe rezulton se ka marrë pjesë në 165 aktivitete që janë të lidhura me këtë organizatë. Përgjatë kësaj periudhe Shqipëria është anëtarësuar edhe në organizatën ndërqeveritare për kërkimin shkencor e inovacionin EUREKA dhe synon të zgjerojë bashkëpunimin me vendet anëtare të këtij konsorciumi.







Figura 2: Kontributi BE për kërkimin shkencor në Shqipëri (milion euro)




Burimi: AKKSHI 2024

Njëkohësisht Shqipëria po ndjek zhvillimet dhe qasjen e Komisionit Evropian, lidhur me parimet e Shkencës së Hapur. Në këtë drejtim kanë filluar përpjekjet se si të ruhen dhe të përdoren të dhënat e kërkimit shkencor në vend, nëpërmjet krijimit të Platformës së Sistemit të Informacionit Shkencor - ACRIS (Albanian Current Research Information System), e cila po zhvillohet në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI).

## Sfidat

Cilësia e arsimit të lartë nëpërmjet përmbushjes së tre misioneve bazë si: mësimdhënia akademike, kërkimi shkencor dhe roli i tij qendror në zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, mbetet sfida kryesore e politikave lidhur me këtë sektor. Duke filluar nga viti 2017, të gjitha institucionet e arsimit të lartë i nënshtrohen akreditimit të detyrueshëm, proces që kryhet nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë (ASCAL). Agjencia gëzon autonomi në hartimin e procedurave dhe kriterëve të vlerësimit në bazë të Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë, si dhe në angazhimin e ekspertëve përkatës. ASCAL-i është anëtar i asociuar i Rrjetit Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA), që ofron udhëzimet e përgjithshme që duhet të ndjekë çdo institucion, përveç plotësimit të rekomandimeve të dhëna në vendimin e Bordit të Akreditimit, si detyrim për t'u plotësuar nga çdo IAL. Sigurimi i brendshëm i cilësisë




është gjithashtu një detyrim ligjor i institucioneve të arsimit të lartë, i cili është përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave që lidhen me realizimin e këtij elementi, dhe një prej rekomandimeve është fuqizimi i strukturave të brendshme të cilësisë.

Në shumicën e institucioneve të arsimit të lartë, infrastruktura didaktike, mësimore dhe kërkimore lidhur me godinat, laboratorët e mjediset e tjera të punës ka pasur përmirësime vitet e fundit, siç e tregon edhe raporti i Bordit. Kjo pritet të ndikojë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies, por edhe të studimeve. Qeveria ka mundësuar aksesin në bibliotekën digjitale EBSCO, ndërkohë që në vitet e fundit ka ndërmarrë nisma të rëndësishme për investime në kampuset e IAL-ve publike dhe në konviktet studentore, siç është hapja e Kolegjit të Evropës dhe fillimi i punës për ndërtimin e kampusit, projekti i ndërtimit të kampusit të ri të Tiranës, Universitetit të Arteve dhe Akademisë së Sigurisë, investimet në Universitetin Politeknik, Universitetin Bujqësor të Tiranës, Universitetin e Sporteve apo në Universitetet e Durrësit dhe Elbasanit.


Me gjithë zhvillimet në fushën e kërkimit shkencor dhe inovacionit, disa sfida dhe prioritetet janë përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor, Teknologjisë e Inovacionit 2023-2030:

- Ka ardhur koha për rritjen më të shpejtë të cilësisë së stafit akademik në institucionet e arsimit të lartë. Sipas raportit të Bordit të Akreditimit të Arsimit të Lartë (2024), për periudhën 2016-2023, ka nevojë të mbështetet një politikë e formimit të stafeve akademike për studimet për gradat dhe titujt. Gjithashtu, po sipas këtij raporti, për të njëjtën periudhë, institucionet e arsimit të lartë në vend kanë një numër shumë të lartë, (48%), të stafit akademik, të punësuar me kohë të pjesshme. Përfundimet e raportit të Bordit të Akreditimit tregojnë se për periudhën 2017-2023, mesatarisht 39 përqind e universiteteve kanë raportuar sfida që lidhen me formimin e vazhdueshëm të stafeve akademike të punësuar në IAL.
- Përmirësimi i cilësisë së programeve të doktoratës të ofruara nga institucionet shqiptare është nevojë imediate për të garantuar cilësi më të lartë të gjeneratës së ardhshme të



akademikëve në universitetet shqiptare. Ky është një tjetër rekomandim i Bordit të Akreditimit, i cili sygjeron ndryshime në grupin mentorëve të studentëve të doktoratës, të cilët duhet të jenë aktivë në fushën e studimeve dhe të botojnë në revista të respektuara ndërkombëtare. Edhe këtu, gjetja e mënyrave për të përfshirë diasporën akademike si pjesë edhe në grupin e supervizorëve, do të ishte e nevojshme.

- Mjedi si ku zhvillohet kërkimi shkencor është kufizuar vetëm në IAL-të, të cilat në shumë pak raste bashkëpunojnë me aktorë të tjerë siç janë institucionet (qëndrore dhe lokale) apo biznesin. Bashkëpunimi i ulët në fushën e kërkimit shkencor, universitet-industri dhe numri i ulët i patentave kërkon nxitjen e tij nëpërmjet programeve të reja të financimit. Kjo kërkon rishikimin e legjislacionit zbatues për të krijuar mekanizma nxitës ligjorë dhe fiskalë, që inkurajojnë bizneset për të financuar kërkimin shkencor, çka është një nga rekomandimet e përsëritura të Komisionit Europian.
- Sipas gjetjeve të raportit të Bordit të Akreditimit, gjatë periudhës 2016-2023, rreth 49% e institucioneve kishin të paktën një problem të rëndësishëm në lidhje me kërkimet shkencore dhe investimet në fushën e shkencës. Kjo është një përqindje që drejton vëmendjen në investime më të mëdha në zhvillimin e zgjerimin e infrastrukturës së kërkimit shkencor.
- Shqipëria duhet të bëjë më shumë përpjekje për të mbledhur e përpunuar të dhëna të sakta që masin treguesit e financimit të kërkimit shkencor përkundrejt GDP, siç janë GBARD dhe GERD.
- Pavarësisht nga interesi për të vepruar në përputhje me parimet e Shkencës së Hapur, Shqipëria është vetëm në hapat e saj të parë të harmonizimit të kërkimit shkencor dhe strategjive të inovacionit me këto parime.
- Universitetet shqiptare kanë nevojë për një ndryshim mentaliteti në lidhje me fushën e studimeve shkencore. Për të arritur standardet e cilësisë, universitetet duhet të vazhdojnë të ndërmarrin studime shkencore cilësore dhe publikime në revista prestigjioze me faktor impakti. Cilësia e publikimeve duhet të jetë kushti kryesor për karrierën e stafit akademik



dhe marrjen e titujve dhe gradave. Në të njëjtën kohë, duhen gjetur mekanizmat për të inkurajuar anëtarët e stafit akademik që të zhvillojnë profilin e tyre shkencor.


- Ka nevojë imediate për të krijuar një fond special, për të publikuar në gjuhën shqipe literaturë/librat bazë dhe mbështetës të çdo programi studimi që ofrohet nga institucionet e arsimit të lartë. Sipas rezultateve të studimit të Bordit të Akreditimit (2024), institucionet e arsimit të lartë kanë nevojë përmirësimi të vazhdueshëm në biblioteka.

## 2.5 Kuadri social

Shtylla kryesore e IAL-ve janë studentët. Përveç praktikës së ofruar nga fakultetet ku ndjekin studimet, studentëve dhe profesionistëve të rinj deri në moshën 26-vjeçare u mundësohet pjesëmarrja në Programin Kombëtar të Praktikave të Punës në administratën shtetërore, në nivel qëndror dhe vendor. Ky program ka përfshirë të rinjtë e studentët në një eksperiencë pune 3-mujore, gjatë së cilës ata integrohen e ndërveprojnë me profesionistë karriere në administratën publike, dhe në fund ofrohen kontrata pune njëvjeçare për 200 të rinj çdo vit.

Duke filluar nga viti 2017 janë ofruar mundësi punësimi edhe për studentët e ekselencës së diplomuar brenda dhe jashtë vendit. Në bazë të kriterëve të përcaktuara, të rinjtë duhet të kenë përfunduar të paktën ciklin e parë të studimeve bachelor dhe/ose master profesional/shkencave me mesatare 9-10 (ose të barasvlershme me to) në secilin prej cikleve të studimit. Në këtë drejtim ka shërbyer platforma “punëtëmbarë.al”, e cila i është kushtuar posaçërisht dhe tërësisht punësimit të studentëve të ekselencës në administratë.

Një nga elementet e ndihmës për studentët, që të ndjekin studimet universitare është mbështetja financiare e ofruar nga qeveria shqiptare. Është garantuar përgjysmimi i tarifës për të gjithë studentët që janë në cikël të parë apo të integruar të studimeve në IAL-të publike, përjashtimi nga tarifa e të gjithë studentëve ekselentë, që kanë notë mesatare 9-10, si dhe të studentëve që vijnë nga kategori në nevojë, pra që janë me ndihmë ekonomike, kanë nevoja të veçanta ose i




përkasin ndonjë kategori tjetër në nevojë. Nga ana tjetër, qeveria shqiptare ka përgjysmuar tarifën e studimeve edhe për disa kategori të studentëve të ciklit të dytë.

Ligji Nr. 80/2015 datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë e Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë”, organizon pjesëmarrjen e studentëve në vendimmarrje nëpërmjet katër elementeve: përfaqësimi i studentëve në Senatin Akademik në masën 10%; pjesëmarrja në zgjedhje për rektor dhe dekan - kuotat e studentëve në përzgjedhje llogariten në masën 10% të totalit të përgjithshëm të votave; e drejta e studentëve të përfaqësohen në të gjitha komisionet e përhershme që organizohen në nivel universiteti dhe në nivel fakulteti; dhe e drejta e studentëve të organizohen në Këshilla Studentore në nivel të institucionit të arsimit të lartë, si dhe në nivel kombëtar.

Një nga zhvillimet më të rëndësishme për mbështetjen e tyre ka qenë pajisja e studentëve me Kartën e Studentit, një nga nismat e Paktit për Universitetin në 2018, që u shoqërua me miratimin e një sërë aktesh nënligjore në këtë drejtim. Një tjetër shërbim i rëndësishëm është edhe ai i mentorimit të studentëve, që realizohet nga zyrat e karrierës në IAL dhe që siguron një mbështetje për studentët, duke u ofruar një sërë përfitimesh si këshillim, përfshirje në praktika të ndryshme kërkimore dhe profesionale apo rrjetëzim me profesionistë.

Ndërkohë, kreditë studentore janë në fazën e parë të zhvillimit, e në këtë kuadër Agjencia Kombëtare për Financimin e Arsimit të Lartë (AKFAL) po realizon marrëveshjet me bankat e nivelit të dytë për ta bërë të mundur këtë shërbim për studentët, që kërkojnë mbështetje financiare, për vitin akademik 2024-2025. Pasi të mblidhen kërkesat e studentëve për të marrë kredi studentore, AKFAL do të veprojë si ndërmjetëse midis tyre dhe bankës. Buxheti i shtetit do të mbulojë deri në 5 për qind të interesit mbi kreditë studentore dhe nuk do të ketë asnjë kërkesë që studentët të vendosin ndonjë kolateral. Studentët do të duhet të fillojnë të shlyejnë kreditë e tyre pas përfundimit të studimeve.


Duhet theksuar se, të rinjtë shqiptarë shfaqin interes për të vazhduar studimet pas përfundimit të arsimit të mesëm. Nëse në vitin 1990, Shqipëria kishte rreth 14 mijë studentë, në vitin 2021 ky



numër shkoi në 124,000 studentë si rrjedhojë e rritjes së kapaciteteve pranuese në arsimin e lartë dhe zgjerimit të ofertës akademike.


Të rinjtë shqiptarë vazhdojnë t'i shohin universitetet publike si ofertën më të rëndësishme akademike për të ndjekur studimet universitare. Këtë prirje e dëshmojnë edhe të dhënat e Eurostat për vitin 2021, referuar “Pjesëmarrjes në arsimin e lartë sipas llojit të institucionit”, ku vërehet se 78% e studentëve studiojnë në IAL publike, ndërsa 22% e studentëve ndjekin studimet në IAL private.

Figura 3: Studentë të regjistruar (2018-2023)



Burimi: Eurostat

Kriteret e pranimit të vendosura nga IAL-të në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, mbështeten kryesisht në arritjet e maturantëve dhe kandidatëve në arsimin e mesëm të lartë. Aplikimi i kandidatëve për studentë, nëpërmjet portalit “U-Albania”, ka bërë të mundur ruajtjen e parimit bazë “meritë-preferencë”, ndërkohë që vendosja e pragut hyrës të mesatares nga arsimi i mesëm i lartë ka rritur cilësinë e atyre që regjistrohen në programet bachelor. Përkundrejt këtyre elementeve, duhet theksuar se në sistemin e arsimit të lartë ka një shumëllojshmëri të madhe të ofertës akademike, ku numri i programeve të studimit është rreth 1,400 në të tre ciklet e studimit.



## 2.6 Kuadri i financimit

Në dhjetë vitet e fundit financimi i arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor është dyfishuar, nga 10 miliardë lekë në vitin 2013, në 20 miliardë lekë në vitin 2024. Gjithashtu kanë pësuar përmirësim të ndjeshëm investimet e bëra në infrastrukturë, nga 2.1 miliardë lekë në vitin 2014, në 3.5 miliardë lekë në vitin 2024. Fondet e buxhetit kanë ardhur në rritje të vazhdueshme duke arritur në 16,180,000 mijë lekë në vitin 2024, që është 40 për qind më shumë krahasuar me 2019.

Tabela 2: Buxheti i Arsimit të Lartë në Shqipëri (000 lekë)

	2019	2020	2021	2022	2023	2024
<b>Totali i fondeve</b>	8,766,492	8,812,526	9,188,778	9,356,014	13,777,293	13,030,000
<b>Buxheti total + IAL publik</b>	11,616,620	11,548,657	11,747,106	12,257,184	16,727,293	16,180,000


Burimi: MoES

Buxheti i shtetit akordon fonde për IAL-të publike dhe kërkimin shkencor nëpërmjet granteve, ku përfshihen: i) granti për politikën e zhvillimit për IAL-të publike, që përbën deri në 10 për qind të vlerës së grantit vjetor total të IAL-të; ii) granti mësimdhënies, i cili përbën të paktën 85 për qind të grantit vjetor total të IAL-të; iii) granti për kërkimin shkencor dhe aktivitetet krijuese, që përbën 5 deri në 10 për qind të grantit vjetor total të IAL-të.

Tabela 3: Buxheti i Kërkimit Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri (000 lekë)

Programet Buxhetore/Vitet	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023
Financimi i Programeve për Kërkim Shkencor	792,717	876,976	709,432	1,130,031	1,681,000
<b>Nxitja e punës kërkimore-Shpenzime administrative</b>	23,660	23,910	23,710	25,000	25,160
<b>AKKSHI</b>					
Financimi programeve kombëtare dhe ndërkombëtare	20,000	51,525	93,613	158,800	173,540
Projekte bashkëpunimi universitet-biznes	36,340	65,859	39,091	38,800	82,300
Tarifë pjesëmarrje për programet kuadër (Horizon Europe), <b>MAS dhe burime të tjera</b>	70,000	70,000		50,600	100,000
	116,171	140,154	2,616	308,268	150,000
Studentë ekselentë/ programe prioritare	200,000	190,000	200,000	122,000	200,000
Infrastrukturë akademike- fonde grant nga buxheti i shtetit	99,500	100,000	195,600	222,000	250,000
<b>Financim i huaj për IAL-të publike (ministria dhe universitetet)</b>	200,000	200,000	100,000	156,100	300,000
<b>Infrastrukturë, fonde nga të ardhurat e universiteteve</b>	27,046	35,528	50,771	48,463	500,000


Burimi: MAS



Granti për politikat e zhvillimit për IAL-të publike, përfshin fondet e nevojshme për funksionimin e institucionit dhe infrastrukturës akademike (*infrastrukturës didaktike dhe kërkimit shkencor*) që janë në dispozicion të IAL-ve dhe shpërndahen në bazë të granteve konkurruese. Fondi për projektet konkurruese për zhvillimin e institucioneve publike të arsimit të lartë është dhënë nga AKKSHI, bazuar në projektet e paraqitura nga IAL-të sipas kriterëve të përcaktuara në strategjitë sektoriale të vendit dhe në ligjin vjetor të buxhetit.

Granti mësimor përbëhet nga fonde institucionale për të mbuluar shpenzimet aktuale të IAL-ve në masën 85%, dhe 10% përbëhet nga fondet e mbështetjes së studentëve. Në kuadër të grantit mësimor, fondi institucional u shpërndahet IAL-ve publike sipas një formule specifike, bazuar në: (i) *numrin e studentëve në një vit akademik pas ciklit të parë të studimeve, një program studimi të integruar, ose një program studimesh profesionale, të cilat shndërrohen në njësi financimi*; (ii) *koeficientët e financimit, bazuar në koston mesatare për student në çdo program studimi*; (iii) *një koeficient i prioriteteve ose i fondeve shtesë me normën 5 për qind, për studentët që ndjekin programet prioritare dhe 10 për qind për studentët në programet e studimit profesional; dhe (iv) të ardhurat e krijuara nga tarifat e shkollimit për çdo IAL, të cilat bazohen në numrin e studentëve të regjistruar dhe nivelin e tavanit të tarifës së shkollimit, të miratuar nga Këshilli i Ministrave për çdo program studimi për studentët që ndjekin ciklin e parë të studimeve, programe të integruara studimesh, ose një program studimesh profesionale. Granti për mbështetjen e studentëve në kuadër të grantit mësimor përfshin tri kategori financimi: (i) bursa për studentë të shkëlqyer; (ii) bursa për studentët në programet e studimit në fushat kombëtare; (iii) bursa për studentët e pambrojtur dhe nevojtarë.*

Granti për kërkimin shkencor dhe aktivitetet krijuese përbën 5 deri në 10 për qind të grantit vjetor total të IAL-ve. Ky grant përfshin aktivitetet e kërkimit shkencor, sipas tre programeve të kërkimit: (i) Programi i zhvillimit të projekteve dypalëshe; (ii) Programi Kombëtar i Kërkim Zhvillimit (PKKZH) dhe (iii) Programi i mbështetjes së teknologjisë dhe inovacionit (bashkëpunimi akademi-biznes ose akademi-institucione).






Grantet për kërkimin shkencor dhe aktivitetet krijuese janë fonde konkurruese në dispozicion të të gjitha IAL-ve të akredituara, që kryejnë kërkime shkencore dhe aplikojnë për financimin e studimeve të doktoratës. Këto fonde shpërndahen nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), bazuar në kriteret e miratuara nga Bordi i Administrimit të AKKSHI-së, sipas prioriteteve kombëtare të kërkimit si dhe duke konsideruar numrin e fakulteteve dhe departamenteve në IAL, numrin e personelit me tituj akademikë, numrin e studentëve në çdo cikël studimi, numrin e laboratorëve, llojet dhe numrin dhe cilësinë e botimeve shkencore.

Formula aktuale e financimit të IAL-ve publike mbështetet kryesisht në numrin e studentëve, programet prioritare dhe të ardhurat që krijojnë IAL-të nga tarifat e shkollimit.

Të ardhurat që kanë arritur të grumbullojnë IAL-të publike, luhaten nga 32.5 përqind të vlerës së buxhetit të shtetit të caktuar për arsimin e lartë, siç u vërejt gjatë vitit akademik 2019-2020, e deri në 21.4 përqind në vitin 2023. Këto të ardhura u rritën 2,950,000 mijë lekë në vitin 2023 dhe do të parashikohet të arrijnë deri në 3,250,000 mijë lekë në vitin 2026. Lidhur me vlerësimin e kostos mesatare vjetore për student në vitin 2023, është vlerësuar të ketë qenë 151,354 lekë dhe ka prirje të rritet deri në 162,000 lekë përgjatë vitit 2025. Fondet shtetërore të akorduara për kërkimin shkencor dhe për Fondet e Ekselencës dhe programet prioritare, për universitetet publike janë rritur nga 364,028,000 lekë në vitin 2019, në 908,860,000 lekë në vitin 2023.




## 3. Arsimi i lartë shqiptar drejt 2030.

### Synimet dhe objektivat kryesore për të ardhmen

Arsimi i lartë në Shqipëri është një segment kyç i zhvillimit kombëtar, me një ndikim të madh në përparimin social dhe ekonomik të vendit. Drejt objektivave të vitit 2030, arsimi i lartë po përballet me një sërë sfidash dhe mundësish që kërkojnë reforma të thella dhe strategji të mirëfillta për të përmbushur kërkesat e kohës dhe për të konkurruar në një treg global të dijes.

Një nga objektivat kryesore për arsimin e lartë shqiptar, është përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Deri në vitin 2030, institucionet e arsimit të lartë do të zhvillojnë programe akademike në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe që i shërbejnë zhvillimit të vendit. Kjo nënkupton rritjen e investimeve në infrastrukturë, biblioteka, botime librash në gjuhën shqipe dhe të huaj, laboratorë dhe teknologji të avancuar për të ofruar një ambient studimi bashkëkohor dhe të pajisur mirë për studentët; rritjen e investimeve që sigurojnë jo vetëm tërheqjen e stafit akademik cilësor në institucionet e arsimit të lartë dhe ekselencën e diasporës akademike, por edhe rritjen e cilësisë së studimeve kërkimore shkencore që kryhen në universitetet shqiptare, të cilat do t'i shërbejnë zhvillimit të mëtejshëm e të gjithanshëm të vendit. Integrimi i teknologjisë në arsimin e lartë është thelbësor për të ndjekur zhvillimet që po ndodhin sot në nivel global. Deri në vitin 2030, universitetet shqiptare do të zhvillojnë dhe zbatojnë platforma të përparuara të mësimdhënies online si forma alternative, duke lejuar akses të barabartë në mësimdhënien akademike për të gjithë studentët, pavarësisht vendndodhjes së tyre. Teknologjia gjithashtu do të luajë një rol kyç në nxitjen e inovacionit dhe kërkimit shkencor, duke krijuar qendra ekselence, ku studentët dhe personeli akademik mund të angazhohen në projekte që sjellin risi në fusha të ndryshme.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë. Institucionet e arsimit të lartë do të nxisin më shumë partneritete me universitetet e huaja dhe do të inkurajojnë e mbështesin programe shkëmbimi për studentët dhe stafin akademik. Kjo do të mundësojë një




rritje të mobilitetit mes studentëve e pedagogëve dhe do të ndihmojë në ndarjen e njohurive dhe përvojave të ndryshme, duke bërë që studentët shqiptarë të jenë më të përgatitur për tregun global të punës. Gjithashtu, ka shumë rëndësi partneriteti me ekselencën e diasporës akademike shqiptare, që do të japë rezultate të shpejta. Është e rëndësishme, gjetja e rrugëve për të tërhequr diasporën shqiptare që të bashkëpunojë me universitetet jo vetëm si vizitorë, por edhe të punësohen apo kryejnë bashkëpunime shkencore me kolegët e tyre në Shqipëri apo në marrjen pjesë në grupet e mentorëve të programeve të doktoratave.

Arsimi i lartë në Shqipëri duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe të nxisë barazinë e mundësive për të gjithë studentët, pavarësisht prejardhjes socio-ekonomike. Universitetet gjithashtu duhet të ofrojnë bursa dhe mbështetje financiare për studentët e talentuar që kanë mundësi të kufizuara ekonomike. Institucionet e arsimit të lartë duhet të kenë një angazhim të palëkundur ndaj parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm, duke nxitur e inkurajuar praktikatat që janë miqësore ndaj mjedisit edhe përmes përfshirjes së edukimit mjedisor në kurrikulat akademike.

Arsimi i lartë shqiptar drejt vitit 2030 duhet të jetë i orientuar drejt inovacionit, cilësisë dhe gjithëpërfshirjes. Me reformat e duhura dhe një vizion të qartë për të ardhmen, arsimi i lartë në Shqipëri mund dhe duhet të bëhet shtylla kryesore e zhvillimit të mëtejshëm të vendit. Angazhimi i të gjithë aktorëve, nga qeveria dhe institucionet arsimore deri te vetë studentët dhe shoqëria civile, është thelbësor për të arritur këtë qëllim ambicioz.

Shtyllat kryesore në të cilat do të mbështeten politikat e zhvillimit të arsimit të lartë në Shqipëri drejt vitit 2030 do të jenë:

- Arsimi i lartë, faktor i rëndësishëm për zhvillimin e kapitalit njerëzor, social dhe ekonomik të vendit, përmes ofertës akademike bashkëkohore, në përshtatje me nevojat e shoqërisë dhe kërkesat dinamike të tregut të punës, për të pajisur studentët me aftësitë e së ardhmes dhe duke synuar rritjen e produktivitetit.
- Implementimi me vendosmëri i të gjitha reformave dhe politikave të Zonës Evropiane të Arsimit (EHEA) dhe Kërkimit Shkencor (ERA), përmes fuqizimit të mekanizmave të



financimit, sigurimit të cilësisë, si dhe duke promovuar ndërkombëtarizimin dhe specializimin rajonal në përputhje me politikat e zhvillimit të qëndrueshëm.

- I. Arsimi i lartë, faktor i rëndësishëm për zhvillimin e kapitalit njerëzor, social dhe ekonomik të vendit, përmes ofertës akademike bashkëkohore, në përshtatje me nevojat e shoqërisë dhe kërkesat dinamike të tregut të punës, për të pajisur studentët me aftësitë e së ardhmes dhe duke synuar rritjen e produktivitetit**

### **Objektivi strategjik I.1: Përmirësimi i ofertës akademike me synim fuqizimin e kapitalit njerëzor**


Objektivi specifik I.1.1: Krijimi i një mjedisi tërheqës për studentët nëpërmjet larmisë së ofertës cilësore akademike, që siguron njohuri, praktikë dhe punësim.

Objektivi specifik I.1.2: Rishikimi i formulës së financimit të IAL-ve me bazë performance dhe cilësie.

Objektivi specifik I.1.3: Riorganizimi i kuadrit ligjor për të mundësuar përshtatjen me tregun e punës.

Arsimi i lartë është shtylla kryesore e zhvillimit të një vendi, duke luajtur një rol të pazëvendësueshëm në formimin e kapitalit njerëzor. Në Shqipëri, përmirësimi cilësor i ofertës akademike në arsimin e lartë është i nevojshëm për të siguruar përgatitjen e të rinjve për sfidat e tregut të punës dhe kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit. Në këtë drejtim, vëmendja duhet t'i kushtohet përmbajtjes, cilësisë së kurrikulës, trajnimit dhe zhvillimit të stafit akademik.

Një kurrikul e përditësuar dhe e përshtatur me nevojat e tregut të punës është thelbësore për përgatitjen e studentëve. Rishikimi i programeve të studimit dhe përfshirja e aftësive praktike janë hapat e parë në këtë drejtim. Kjo nënkupton jo vetëm përmirësimin e përmbajtjes teorike,




por edhe integrimin e praktikave profesionale dhe projekteve reale, ku studentët mund të përballen me situata konkrete të punës. Për më tepër, kurrikula duhet të jetë e zhdërvjellët dhe të mundësojë ndërdisiplinaritetin, duke i lejuar studentët të zhvillojnë një tërësi të gjerë aftësish. Për të maksimalizuar procesin e përshtatjes kurrikulare me kërkesat evolutive të tregut të punës, duhet të propozohen ndryshime në kërkesat ligjore për sa i përket procedurave të hapjes së programeve të reja të studimit.

Cilësia e stafit akademik është thelbësore në arritjen e një arsimit të lartë cilësor. Për këtë arsye, është e domosdoshme të investohet në tërheqjen dhe punësimin e një stafi akademik të kualifikuar e cilësor, me tituj e grada, të cilët të inkurajohen të kryejnë studime shkencore cilësore, por dhe mësimdhënie cilësore, mbi të cilat të bazohet edhe progresi i tyre në karrierë. Në këtë drejtim, tërheqja e ekselencës së diasporës akademike, do të ishte një strategji e suksesshme, pasi do të rriste cilësinë e studimeve shkencore në IAL, mësimdhënies dhe përgatitjes së stafeve akademike më cilësore në të ardhmen. Organizimi i trajnimeve të rregullta për përmirësimin e metodave pedagogjike, si dhe përfshirja e ekspertëve ndërkombëtarë për të ndarë përvojat dhe praktikat më të mira, konsiderohen strategji të suksesshme. Kjo do të sigurojë që pedagogët të jenë të përgatitur për të ofruar një arsim cilësor dhe të jenë në hap me zhvillimet e fundit në fushat e tyre.

Një nga elementet për arsim të lartë cilësor është infrastruktura moderne dhe burimet njerëzore e infrastrukturore, të cilat kanë shfaqur disa problematika sipas gjetjeve të Raportit të Bordit të Akreditimit (2024). Për të përballuar sfidat e ardhshme është domosdoshmëri investimi nga ana e IAL-ve në laboratorë, biblioteka, qendra kërkimore dhe pajisje teknologjike. Gjithashtu, zgjerimi i shërbimit të bibliotekave universitare drejt formave e burimeve online të informacionit shkencor, bibliografik do të mundësojë që studentët dhe pedagogët të kenë qasje në literaturën dhe materialet më të fundit.

Mbështetja e studentëve gjatë gjithë periudhës së studimeve është një faktor kyç për suksesin e tyre akademik dhe profesional. Programet e mentorimit dhe këshillimit kanë rëndësi për të ndihmuar studentët të përballen me sfidat akademike dhe të zhvillojnë aftësitë e nevojshme. Për




më tepër, mbështetja e aktiviteteve jashtëkurrikulare, siç janë klubet studentore dhe projektet komunitare, do t'i ndihmojnë ata të zhvillojnë aftësi të ndryshme dhe të krijojnë rrjete sociale dhe profesionale. Ndërmarrja e iniciativave të vazhdueshme për zhvillimin e dimensionit social si pjesë integrale të mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke marrë hapa konkretë, si për shembull: krijimi i grupeve institucionale për implementimin e objektivave specifike të strategjisë së dimensionit social në institucionet e arsimit të lartë, duke synuar zhvillimin e mëtejshëm të mundësive për orientimin e studentëve drejt mendimit analitik dhe ndërdisiplinor, duke i përgatitur për tregun e punës.

Politikat qeveritare mbështetëse dhe financimi i duhur janë thelbësore për përmirësimin e ofertës akademike. Në vijim të këtij synimi, bursat dhe grantet për studentët e talentuar dhe ata në nevojë do të sigurojnë qasje të barabartë në arsim të lartë, ashtu sikurse politikat që lehtësojnë investimet në arsimin e lartë dhe nxisin zhvillimin e tij të qëndrueshëm do të krijojnë një mjedis të favorshëm akademik dhe shkencor.

Krijimi i një fondi të veçantë financimi për botimin apo përkthimin e literaturës/librave bazë dhe mbështetës për të gjitha programet e studimit të ofruara nga institucionet në vend, është një nevojë shumë e rëndësishme për të ofruar oferta të përmirësuara akademike në të ardhmen. Sipas gjetjeve të Bordit të Akreditimit, probleme me literaturën, bibliotekat dhe me infrastrukturën, ka pasur në rreth 36% të programeve të vlerësuara gjatë periudhës 2018-2023. Për këtë arsye, është e rëndësishme të gjenden mekanizmat e duhur konkurrues për të inkurajuar stafin akademik dhe institucionet të aplikojnë për këto fonde speciale, dhe të botojnë libra bazë, por edhe mbështetës për çdo program studimi, ndërsa institucionet duhet të shtojnë investimet në rritjen e fondit të bibliotekave që janë shumë të varfëra.

Përmirësimi i ofertës akademike në arsimin e lartë në Shqipëri është një proces kompleks që kërkon një qasje të gjithanshme dhe të mirëkoordinuar. Për këtë arsye, ka rëndësi që institucionet e arsimit të lartë të rishikojnë e përditësojnë programet, të fuqizojnë stafin akademik dhe të forcojnë bashkëpunimin me sektorin privat e institucionet ndërkombëtare.




Një element me rëndësi, përfshirë në cilësinë e arsimit të lartë, është mbështetja e studentëve që përbën thelbin për suksesin e tyre akademik dhe individual. Shqipëria ka nisur tashmë një plan ambicioz për të përmirësuar mbështetjen e studentëve në arsimin e lartë, duke synuar që deri në vitin 2030, çdo student të ketë të gjithë instrumentet e duhura mbështetëse. Ky udhëtim drejt transformimit filloi me identifikimin e nevojave të studentëve dhe krijimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për t'u dhënë atyre rrugëzgjidhje. Gjatë këtyre viteve janë ndërmarrë disa hapa në këtë drejtim, siç është krijimi i Qendrave të Këshillimit Akademik, ku studentët mund të marrin udhëzime për zgjedhjen e kurseve dhe planifikimin e karrierës. Kjo qasje është shoqëruar me zhvillimin e Programeve të Mentorimit, duke i lidhur studentët e rinj me mentorët e tyre dhe përmes zgjerimit të Programeve të Këshillimit Individual «Tutoring», për të ndihmuar studentët në lëndët që i konsideronin të vështira. Brenda tre viteve, këto nisma filluan të dëshmojnë rezultate pozitive, me një rritje të ndjeshme të suksesit akademik dhe të studentëve.

Me kalimin e viteve u bë gjithnjë e më e qartë që përgatitja për tregun e punës ishte thelbësore për suksesin e studentëve pas diplomimit. Në këtë kuadër shërbejnë Qendrat e Karrierës, që u krijuan në të gjitha universitetet, duke ofruar këshillim karriere, trajnime, mundësi për praktika dhe punësim. Panairot e punës dhe aktivitetet për krijimin e rrjeteve profesionale, kanë qenë një mundësi e mirë për të lidhur studentët me punëdhënësit e mundshëm, duke nxitur mundësitë për karrierë.

Ndërkohë, skemat e bursave dhe granteve janë zgjeruar duke ofruar më shumë mundësi për studentët në nevojë. Përmirësimi i statusit socio-ekonomik të studentëve nëpërmjet ofrimit të shërbimeve cilësore dhe formave të ndryshme të asistencës financiare, është një nga pikat kryesore në të cilat mbështeten politikat e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Me gjithë vëmendjen e shtuar në vitet e fundit për përmirësimin e shërbimeve të studentëve, ka nevojë për zgjerimin e larmisë së tyre, në përputhje me praktikat më të mira të IAL-ve evropiane. Shërbimi i mentorimit të studentëve duhet nxitur më tej, në mënyrë që studentët të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë profesionale.

Objektivat kryesore në lidhje me studentët dhe mbështetjen ndaj tyre janë:



- Pasurimi dhe përmirësimi i shërbimeve për studentët, duke pasur në qendër të vëmendjes zgjerimin e mbështetjes financiare përmes bursave për studentët ekselentë si dhe për ata që u përkasin grupeve specifike social-ekonomike;
- Mbështetja e studentëve për përmirësimin e arritjeve akademike dhe ofrimi i shërbimit të këshillimit (tutoring) në rastet kur mungon;
- Sistemi i mentorimit për të rritur efikasitetin në realizimin e praktikave të studentëve, sidomos të kandidatëve për mësues; forcimi i bashkëpunimit me industrinë në kuadër të praktikës profesionale dhe krijimi i rrjeteve të praktikave profesionale;
- Rritja e orëve praktike, veçanërisht për studentët e fushave mjekësore dhe inxhinierike;
- Zgjerim dhe përmirësim të cilësisë së Programit Kombëtar të Praktikave për studentët;
- Përmirësim të bazës ligjore për njohjen e mikrokrediteve;
- Nxitje të bashkëpunimit ndërmjet IAL-ve dhe Këshillave Studentorë, si dhe rritje të pjesëmarrjes studentore në komisionet e IAL-ve;
- Rritje të mobiliteteve për studentët, sidomos për ata të mësuesisë dhe STEAM.

Financimi i Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) me bazë performancën dhe cilësinë, është një strategji që mund të sjellë përmirësime të ndjeshme në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. Zbatimi i suksesshëm i këtij modeli kërkon një planifikim të kujdesshëm, përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara dhe sigurimin që kriteret e vlerësimit të jenë të drejta dhe transparente. Me një qasje të tillë, Shqipëria mund të përmirësojë cilësinë e arsimit të lartë dhe të fuqizojë kapitalin e saj human për të ardhmen.

Një nga përfitimet kryesore të financimit me bazë performancën, është nxitja dhe inkurajimi i cilësisë në mësimdhënie akademike dhe kërkim shkencor. Institucionet që tregojnë rezultate të larta në këto fusha do të shpërblehen financiarisht, duke i inkurajuar të investojnë më shumë në përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe kërkimit. Me më shumë financime të bazuara në cilësi, institucionet mund të investojnë në pajisje moderne dhe burime të tjera të nevojshme për një mjedis arsimor të avancuar. Financimi me bazë performancën rrit transparencën dhe llogaridhënien. Institucionet duhet të raportojnë rregullisht rezultatet e tyre, duke siguruar një






proces të drejtë dhe transparent të shpërndarjes së fondeve. Fokusi në performancë dhe cilësi do të kërkojë nga institucionet të përmirësojnë menaxhimin dhe administrimin e tyre për të arritur rezultatet e kërkuara. Krijimi i një mjedisi konkurrues është një tjetër përfitim i rëndësishëm. Financimi me bazë performancën krijon një mjedis, ku institucionet përpiqen të tejkalojnë njëra-tjetrën në cilësi dhe performancë. Në përpjekjen për të arritur rezultate të larta, institucionet do të inkurajohen të zhvillojnë dhe të zbatojnë metoda të reja dhe inovative në mësimdhënie dhe kërkim.

Financimi i IAL-ve me bazë performancën dhe cilësinë, është një strategji që mund të sjellë përmirësime të ndjeshme në cilësinë e arsimit të lartë në Shqipëri. Megjithatë, zbatimi i suksesshëm i këtij modeli kërkon një planifikim të kujdesshëm, përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara dhe sigurimin që kriteret e vlerësimit të jenë të drejta dhe transparente. Me një qasje të tillë, Shqipëria mund të përmirësojë cilësinë e arsimit të lartë dhe të fuqizojë kapitalin e saj human për të ardhmen.

Sot, Universiteti Smart (Universiteti 4.0 ose Universiteti inteligjent) është një model gjithnjë e më i pranishëm drejt së cilit duhet të shkojë dhe arsimit të lartë shqiptar. Një universitet që ofron mënyra inovative të punës, të mësuarit dhe mësimdhënies është objektivi kryesor për 2030. Kjo nënkupton hapësira që integrojnë në mënyrë krijuese platforma të avancuara infrastrukturash të teknologjive të informacionit, të cilat përdorin të dhëna të shumta, edukim në distancë, media sociale e zbatimin e modeleve të lidhura me Inteligjencën Artificiale (IA). Në përshtatje me ndryshimet e kohës, sigurisht që lind natyrshëm nevoja e rishikimit të kornizës ligjore, për ta përshtatur sa më shumë me prirjet botërore të arsimit të lartë si dhe me synim përmirësimin e vazhdueshëm të arsimit të lartë. Si rezultat i dinamikës së zhvillimit të arsimit të lartë, ka rezultuar nevoja për rishikim të udhëzimeve të dala nga ky ligj.

Vlerësohet se ka ardhur koha për pilotimin e sistemeve major-minor në arsimin e lartë në Shqipëri. Studentët do të kenë mundësinë të kombinojnë fusha të ndryshme, p.sh., Ekonomi (major) + Teknologji Informacioni (minor) ose Marrëdhënie Ndërkombëtare (major) +




Komunikim (minor). Kjo do të rrisë ndërdisiplinaritetin dhe do t'i ndihmojë studentët të përgatiten më mirë për tregun e punës.

Ndikimi në tregun e punës - Kombinimi i aftësive teknike dhe teorike nga fusha të ndryshme do ta bëjë më të lehtë për studentët të përshtaten me kërkesat e tregut të punës. Punëdhënësit do të mund të marrin kandidatët me aftësi të kombinuara, si p.sh. Financa + Data Science ose Drejtësi + Marrëdhënie Ndërkombëtare.

Sa më sipër do të kërkonte përditësimin e Ligjit për Arsimin e Lartë për të lejuar ndarjen e diplomave në një program kryesor (major) dhe një program dytësor (minor) dhe ristrukturim të kurrikulës universitare. Në këtë kuadër hapat mund të lidhen me:

- Krijimin e rregullave të reja për transferimin e krediteve midis programeve të ndryshme të studimit.
- Universiteteve do t'u duhet të rishikojnë programet ekzistuese për të përcaktuar se si mund të strukturohen majorët dhe minorët brenda një diplome.
- Ndryshime në akreditimin dhe diplomimin - Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) do të duhet të përshtasë kritere të reja për akreditimin e programeve me sistem major-minor.
- Adaptimi i sistemit të krediteve (ECTS) - Një major zakonisht përbën rreth 70% të krediteve të programit, ndërsa një minor rreth 30%. Shqipëria tashmë ndjek sistemin ECTS (European Credit Transfer System), kështu që kjo ndarje mund të implementohet pa ndryshime të mëdha teknike.
- Krijimi i një bërthamë të përbashkët akademike, ku studentët ndjekin lëndët e detyrueshme të programit kryesor, ndërsa minorët ofrojnë një shtesë të specializuar në një fushë tjetër, duke incentivuar bashkëpunimin ndër universitar.

Fillimisht mund të pilotohet në Universitetin e Tiranës, Universitetin Politeknik, Universitetin e Mjekësisë dhe Universitetin e Durrësit, për të testuar funksionalitetin dhe për të bërë rregullime bazuar në rezultatet e para.



Ky model do ta modernizonte arsimin e lartë shqiptar dhe do t'i jepte më shumë fleksibilitet dhe mundësi zgjedhjeje studentëve, në përputhje me standardet ndërkombëtare.


## **Objektivi strategjik I. 2: Forcimi i lidhjeve me tregun e punës dhe profilizimi i universiteteve, bazuar në nevojat kombëtare dhe rajonale**

**Objektivi specifik I.2.1:** Nxitja e profilizimit rajonal të institucioneve të arsimit të lartë, me një ofertë akademike dhe programe studimi bazuar në nevojat kombëtare dhe rajonale.

**Objektivi specifik I.2.2:** Bashkëpunimi me sektorin privat, zhvillimi i partneriteteve me industrinë dhe sektorët e tjerë për të ofruar praktika profesionale dhe mundësi punësimi për studentët.

**Objektivi specifik I.2.3:** Institucionet e arsimit të lartë, të zhvillojnë dhe të ofrojnë edhe shërbime ndaj të tretëve.

Arsimi i lartë synon që t'u sigurojë të diplomuarve aftësitë e nevojshme për të pasur sukses në tregun e punës nëpërmjet zhvillimit të kurrikulave që i përgjigjen kontekstit të ekonomive të sotme të globalizuara, të drejtuara nga inovacioni dhe të bazuara në aftësi. Sistemet e arsimit të lartë përpiqen të «prodhojnë» të diplomuar me njohuri dhe aftësi të theksuara teknike, profesionale dhe të disiplinës specifike, cilado qoftë fusha e tyre e studimit. Zhvillimi i programeve të reja të studimit duhet të jetë në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit, në përputhje me prioritetet kombëtare, ndërthurur me bashkëpunimin me universitetet partnere në Bashkimin Evropian dhe më gjerë, ku një ndihmë të veçantë mund të ofrojë diaspora akademike. Programet e studimeve profesionale, të cilat janë të orientuara drejt përvetësimit të aftësive praktike, duhet të jenë më fleksibël për të plotësuar nevojat afatshkurtra të tregut të punës. Institucionet e arsimit të lartë që gjenden në rajone të ndryshme të vendit, duhet të profilizohen sipas nevojave specifike të rajonit përkatës. Bashkëpunëtorët nga radhët e bizneseve dhe kryesisht të sektorëve privatë, të jenë pjesë integrale e bordeve drejtuese të institucioneve



arsimore, të njësive kryesore si dhe e grupeve kërkimore shkencore, me qëllim që njohuria e tyre praktike dhe eksperiencia në fushat ku ata janë pjesë e operimit të përditshëm, të vihet në dispozicion të institucionit dhe sigurisht edhe të studentit.


Universitetet duhet të jenë institucione me dyer të hapura, ku marrja e dijeve mos të jetë vetëm ekskluzivitet i studentëve aktualë, por të japë mundësi publikut që të regjistrohet pranë institucioneve arsimore për t'u pajisur me kredite të tjera për lëndë dhe module në të cilat kanë interesa për të ndjekur, duke pasur avantazhin që këto kredite të mund të përdoren në çdo kohë kur t'u lindë nevoja.

Disa nga problematikat që hasen aktualisht mund të përmbliidhen si vijon:

- Kurrikulat nuk u janë përshtatur gjithnjë ndryshimeve shoqërore-ekonomike dhe nevojave të kohës, për pasojë, ato nuk kanë qenë gjithmonë të rëndësishme për tregun e punës. Raporti i Bordit të Akreditimit (2024) thekson se shumë programe studimi kanë probleme me kurrikulat, dhe shpesh nuk reflektojnë nevojat e tregut të punës. Sipas treguesve të studimit, gjysma (50%) e programeve të vlerësuara gjatë periudhës 2018-2023 kishin të paktën një problem kryesor në lidhje me kurrikulën, ndërsa 25% e të gjithë programeve të vlerësuara në të njëjtën periudhë, u gjetën me të paktën një mangësi të rëndësishme në lidhje me tregun e punës.
- Institucionet e arsimit të lartë nuk shfrytëzojnë mundësinë ligjore për të ofruar programe të formimit në vazhdim, si formë e të mësuarit gjatë të gjithë jetës.
- Gjithashtu IAL-të, sidomos ato të rretheve, kanë humbur identitetin rajonal të veprimitarisë akademike që ka ekzistuar më parë.


Objektivat kryesore në lidhje me përmirësimin e lidhjeve me tregun e punës janë:

- Përputhja e kurrikulës me nevojat e tregut, sigurimi që programet akademike të jenë në përputhje me kërkesat dhe nevojat e tregut të punës. Një nga rekomandimet kryesore të raportit të Bordit të Akreditimit është edhe përmirësimi i cilësisë së kurrikulave të ofruara nëpërmjet përmirësimit të Standarteve të Cilësisë, mbi të cilat ato vlerësohen. Për t'u



arritur kjo, Bordi rekomandon krijimin e mekanizave për botimin e literaturës kryesore dhe mbështetëse në gjuhën shqipe për çdo program studimi, sidomos të ciklit profesional dhe Bachelor.

- Bashkëpunimi me sektorin privat, zhvillimi i partneriteteve me industrinë dhe sektorët e tjerë për të ofruar praktika profesionale dhe mundësi punësimi për studentët;
- Profilizimi rajonal i Institucioneve të Arsimit të Lartë, ku një fokus i veçantë t’i jepet dhe programeve të mësuesisë, duke u fokusuar tek nevojat për ridimensionimin e programeve të mësuesisë bazuar në kurrikulat e reja dhe me metodat moderne të mësimdhënies.
- Rritja e mundësive për punë praktike në studimet e larta, duke zhvilluar partneritete strategjike me biznesin;
- Promovimi i ndërdisiplinaritetit dhe programeve STEAM;
- Ndryshimi i kuadrit ligjor me qëllim njohjen dhe përfshirjen e programeve profesionale në punësim;
- Rrëshikimi i kuotave të kërkuara nga IAL-të, duke tentuar të ulet fiktiviteti dhe kuotat e kërkuara të jenë në përputhje me nevojat reale të tregut të punës në vend;
- Forcimi i dialogut dhe i rolit të biznesit dhe partnerëve profesionalë në projektimin dhe rishikimin e programeve të studimit;



II. Implementimi i reformave dhe politikave të Zonës Evropiane të Arsimit (EHEA) dhe Kërkimit Shkencor (ERA), përmes fuqizimit të mekanizmave të financimit, sigurimit të cilësisë, si dhe duke promovuar ndërkombëtarizimin dhe specializimin rajonal në përputhje me politikat e zhvillimit të qëndrueshëm.


**Objektivi strategjik II.1:** Rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor nëpërmjet ndërkombëtarizimit, financimit të qëndrueshëm dhe inovacionit.

**Objektivi specifik II.1.1:** Fuqizimi i kërkimit shkencor në IAL përmes rritjes së financimit, rritjes së cilësisë së stafit akademik, tërheqjes së diasporës akademike, gjithëpërfshirjes, ndërkombëtarizimit dhe shkencës së hapur.

**Objektivi specifik II.1.2:** Fuqizimi i standardeve të cilësisë në mësimdhënie përmes matjes dhe vlerësimit të vazhdueshëm të tyre.


**Objektivi specifik II.1.3:** Matja e performancës në kërkim shkencor e projekte, si bazë për një financim të qëndrueshëm.

Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë është një element kritik për të garantuar që universitetet dhe institucionet arsimore të përmbushin standardet ndërkombëtare dhe për të rritur konkurrueshmërinë e tyre në tregun global. Integrimi në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA) kërkon përkushtim të veçantë ndaj cilësisë dhe përshtatjes me praktikat më të mira evropiane. Sigurimi i cilësisë përfshin të gjitha proceset dhe mekanizmat që synojnë përmirësimin e standardeve arsimore dhe mësimore në institucione të arsimit të lartë. Ky proces është i domosdoshëm për të siguruar që studentët marrin një arsimim të cilësisë së lartë, që është i njohur dhe i vlefshëm ndërkombëtarisht.



Mësimdhënia në arsimin e lartë luan një rol kyç në formimin e gjeneratave të ardhshme dhe në përgatitjen e tyre për tregun e punës dhe për sfidat e jetës. Në kontekstin e Shqipërisë, arsimit i lartë ka bërë përparime të konsiderueshme gjatë viteve të fundit, por gjithashtu përballet me sfida të shumta që kërkojnë zgjidhje dhe përmirësime. Objektivat drejt vitit 2030 për arsimin e lartë duhet të jenë të qarta dhe ambicioze, duke pasur parasysh nevojat e shoqërisë dhe tendencat globale. Sfidat dhe problematikat e hasura për të pasur një mësimdhënie cilësore akademike në institucionet e arsimit të lartë kanë nevojë për hartimin e zhvillimin e ekuilibruar dhe të integruar të politikave, për rishikimin, përmirësimin e vlerësimin e programeve të studimit. Përsa i përket programeve të studimit që zhvillohen në IAL-të publike e jopublike, numri i tyre i lartë prej rreth 1,400, të shtrira kryesisht në ciklin e parë dhe ciklin e dytë të studimeve, ka dëshmuar se ato kanë përmbajtje dhe burime të ndryshme financimi, stafi akademik e bazë laboratorike. Ndërkohë, edhe shtrirja e tyre në kohë është e ndryshme, duke filluar nga programet 2-vjeçare të kolegjeve profesionale e deri tek programet e integruara që zgjasin deri në 6 vjet, siç janë ato të Mjekësisë së Përgjithshme.

Një nga objektivat kryesore drejt 2030 duhet të jetë përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies. Ky përmirësim mund të arrihet nëpërmjet investimeve në tërheqjen e një stafi akademik ekselent, atyre të doktoruar jashtë në universitete të njohura evropiane dhe jo vetëm, apo tërheqjes së studiuesve/profesorëve shqiptarë të njohur që punojnë në universitete jashtë vendit; ndryshimin e akteve mbi kualifikimin e stafit akademik, ku të kufizohet numri pedagogëve pa tituj e grada (ata që janë vetëm me diplomë masteri), si dhe i atyre që punojnë me kohë të pjesshme. Këto rekomandime janë dhënë nga raporti i Bordit të Akreditimit. Gjithashtu, dhe aktet nënligjore për progresin në karrierë të stafit akademik, duhet të forcohen edhe më tej, duke i dhënë rëndësi edhe më të madhe cilësisë së publikimeve në revista shkencore të njohura dhe me faktor impakti, ndërsa akademikët duhet të stimulohen për të prodhuar e publikuar studime shkencore cilësore, për të botuar edhe literaturë në gjuhën shqipe.




Një tjetër objektiv i rëndësishëm është integrimi i teknologjisë në procesin e mësimdhënies. Teknologjia mund të ndihmojë në krijimin e një mjedisi mësimor më ndërveprues dhe ku përfshihen të gjithë studentët. Përdorimi i platformave online, materialeve multimediale dhe mjeteve digjitale mund të përmirësojë ndjeshëm cilësinë e mësimdhënies dhe të lehtësojë procesin e të mësuarit për studentët. Për këtë qëllim duhet të investohet në infrastrukturën teknologjike dhe të sigurohet që çdo student të ketë qasje në pajisje dhe internet.

Arsimi i lartë duhet të jetë më i lidhur me tregun e punës, duke synuar që programet e studimit të jenë të zhdërvjellëta dhe të përditësohen rregullisht për t'u përshtatur me nevojat e industrisë. Bashkëpunimi me bizneset dhe organizatat mund të ndihmojë në krijimin e programeve që ofrojnë aftësi praktike dhe eksperiencë të drejtpërdrejtë për studentët. Praktikantet profesionale dhe projektet e përbashkëta janë mënyra efektive për të përgatitur studentët për karrierën e tyre të ardhshme. Gjithashtu, promovimi i kërkimit shkencor dhe inovacionit duhet të jetë një prioritet.

Universitetet duhet të inkurajojnë dhe mbështesin kërkimin shkencor në fusha të ndryshme, duke ofruar fonde dhe burime për studentët dhe pedagogët. Kjo do të ndihmojë në zhvillimin e ideve të reja dhe në përmirësimin e njohurive shkencore që mund të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit. Në këtë drejtim, një nga rekomandimet e raportit të Bordit të Akreditimit është që universitetet të marrin fonde shtesë nga qeveria dhe të inkurajojnë stafin e tyre akademik për të kryer studime kërkimore shkencore e cilësore, si dhe të riorganizojnë dhe përmirësojnë procesin e shpërndarjes së fondeve në nivel departamenti dhe monitorojnë progresin.

Objektivat kryesorë në lidhje me ndryshimet në kornizën ligjore të arsimit të lartë gjatë kësaj periudhe do jenë si më poshtë:

- Mbështetja e stafit akademik për të hartuar planet e rritjes profesionale për përfitimin e titujve dhe gradave, për të avancuar në karrierën akademike brenda një afati 3-vjeçar, si dhe ulja e mëtejshme e përqindjes së stafit me kontrata të pjesëshme;






- Forcimi i qasjes së mësimdhënies akademike në formë të përzier «blended», në auditorë dhe online duhet të shihet si një mundësi për modernizimin e aspekteve të mësimdhënies, hapësira më të mëdha për të përfshirë staf akademik (profesorë vizitorë) nga universitete të ndryshme të botës apo ekspertë të një fushe të caktuar (lektorë të ftuar);
- Krijimi i një infrastrukture të qëndrueshme të mësimdhënies akademike në tre format e saj: tradicionale (auditor), online dhe të përzier (auditor&online) dhe përmes rregullimeve ligjore dhe standardeve europiane;

Synohet përmirësimi i përmbajtjes së kërkimit shkencor, mbështetur në përparësitë kombëtare dhe nën optikën e përparësive aktuale të zhvillimit të vendit. Për të arritur këtë, rol tepër të rëndësishëm ka tërheqja e diasporës akademike, e cila është një forcë tepër e rëndësishme, që do të ndikojë drejtëpërdrejt jo vetëm në rritjen e cilësisë së studimeve shkencore të kryera nga institucionet shqiptare, por edhe në bashkëpunimet me institucionet e huaja, ku ata bëjnë pjesë, rritjes së cilësisë së mësimdhënies, duke arritur kështu një rritje të cilësisë së arsimit të lartë në vend. Studimet shkencore duhet të jenë në qendër të politikave të institucioneve të arsimit të lartë, dhe këto studime të vihen edhe në funksion të zhvillimit të mëtejshëm të vendit.

Ajo që aktualisht vihet re është se kërkimi shkencor, si komponent i rëndësishëm kyç për institucionet e arsimit të lartë, është më tepër një veprimtari që varet nga nismat individuale. IAL-të duhet të reflektojnë dhe të ndryshojnë rrënjësisht kulturën e të bërit studime kërkimore-shkencore. Ndryshimi dhe përmirësimi i mëtejshëm i standardeve të cilësisë në këtë drejtim duhet t'u kërkojë universiteve që të kryejnë studimet shkencore cilësore dhe të publikojnë në revista cilësore me faktor impakti.


Avancimi në karrierën akademike mbështetet në tregues që kanë të bëjnë me publikimet, përfshirjen në projekte të ndryshme kërkimore shkencore, kombëtare dhe ndërkombëtare, ndërsa performanca në fushën e mësimdhënies konsiderohet si kriter dytësor. Në disa programe vazhdojnë të përdoren gjerësisht metodat e vjetëruara të mësimdhënies, që fokusohen në



memorizim dhe riprodhimin e fakteve, duke neglizhuar nevojën për aftësimin e studentëve që të nxënë gjatë të gjithë jetës dhe të zgjidhin probleme komplekse nga fusha e tyre e specializimit.

Objektivat kryesore në lidhje me rritjen e cilësisë në kërkimin shkencor në arsimin e lartë janë:


- Tërheqja e një stafi akademik sa më të kualifikuar në universitetet shqiptare, sidomos atyre të diasporës për të qënë të pranishëm në Shqipëri në forma të ndryshme (pedagogë, me kohë të plotëm ose pjesëtime, bashkëautorë studimesh, bashkëmentorë të studentëve të doktoratës, vizitorë me kohë të pjesëtime, ftesa për të marrë pjesë në seminare apo leksione të hapura etj.);
- Bashkëpunimin në fushën shkencore me akademikë të diasporës apo dhe më gjerë, ku duhet të investohet për projekte të përbashkëta dhe aplikime në fondet evropiane;
- Duhet synuar angazhimi afatshkurtër dhe afatgjatë i diasporës akademike në institucionet e arsimit të lartë. Duhet që brenda organikës së AKKSHI të krijohet një njësi e veçantë, për të identifikuar diasporën akademike, të doktoruarit në vendet e BE-së dhe Amerikës Veriore; duke krijuar regjistrat sipas profileve shkencore; duke i mbajtur në kontakt nëpërmjet informacioneve të vazhdueshme; duke bashkërenduar me IAL-të në vend për t'i ftuar, përfshirë dhe tërhequr këtë ofertë të jashtëzakonshme që ofrojnë ata;
- Fuqizimi i rolit të grupeve mësimore - kërkimore brenda departamenteve;
- Përmirësimi i cilësisë së doktoratës ofruar në vend, duke përfshirë bashkëudhëheqje me profesorë të huaj dhe diasporën akademike. Në këtë kontekst duhet të rivlerësohet ngarkesa e asistentëve gjatë periudhës së kryerjes së doktoratës. Personeli akademik me titull “profesor”, që është aktiv në kërkime shkencore të mirëfillta dhe publikon në revista shkencore cilësore, duhet të jenë pjesë e grupit të mentorëve të studentëve të doktoratës.
- Vlerësim për arritje të spikatura në shkencë për personelin akademik, duhet të shoqërohen me incentiva financiare;
- Të ndërtohet një mekanizëm i ri mbi metodologjinë kombëtare të vlerësimit të kërkimit në IAL.



Partneritetet me institucionet ndërkombëtare janë kyçe për zhvillimin e arsimit të lartë. Krijimi i programeve të përbashkëta me bizneset lokale dhe ndërkombëtare, si dhe mundësitë për praktika profesionale, do të ndihmojnë studentët të fitojnë përvojë të vlefshme dhe të krijojnë rrjete profesionale. Gjithashtu, projektet e përbashkëta kërkimore me universitete dhe qendra kërkimore ndërkombëtare do të kontribuojnë në zhvillimin e inovacionit dhe shkëmbimin e përvojave. Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë në Shqipëri dhe integrimi në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA) është në fokus të vazhdueshëm nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë tashmë nuk është një koncept i ri. Ai ndërlidhet me mobilitetin e shtuar të studentëve, stafit akademik, programet e përbashkëta me universitete të huaja, përfshirjen në projekte etj.

Bashkimi Evropian i ka dhënë shumë rëndësi mobilitetit të studentëve, stafit akademik dhe hulumtuesve, duke krijuar për këtë qëllim programe të veçanta, si: Erasmus+, “Marie Curie”, CEEPUS etj. Qëllimi i programeve të tilla është njohja dhe përfshirja e studentëve dhe stafit akademik ndaj përvojave më të mira evropiane, si dhe krijimi i raporteve të bashkëpunimit midis IAL-ve shqiptare dhe atyre evropiane, duke i kontribuar kështu integritit sa më të mirë të Shqipërisë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë. Shqipëria do të përfitonte nga krijimi i programeve të përbashkëta të IAL-ve shqiptare me ato të Bashkimit Evropian, që do të ndikonin në rritjen e cilësisë së ofertës në vend, ndërkaq, nëse këto programe janë në gjuhën angleze, do të mund të ishin tërheqëse edhe për studentë të huaj, prania e të cilëve do të ishte një vlerë e shtuar për arsimin e lartë shqiptar. Promovimi dhe nxitja e mëtejshme procesit të ndërkombëtarizimit do të frenojë largimin e studentëve jashtë vendit.

Vitet e fundit është shtuar numri i studentëve dhe stafeve akademike që marrin pjesë në programet e shkëmbimit. Për këtë arsye është e rëndësishme që të rritet numri i aplikantëve që kanë mundësinë të jenë pjesë e përvojave të ndryshme ndërkombëtare, ndërkohë që edhe IAL-të kanë krijuar një traditë për njohjen e krediteve të mobilitetit.




Ndërkombëtarizimi i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri ka për qëllim të përmirësojë cilësinë e arsimit, të rrisë konkurrencën dhe të promovojë shkëmbimet akademike dhe kulturore ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera.

Hapja e degëve dhe universiteteve ndërkombëtare, me synimin e diversifikimit të ofertës akademike, duhet bërë përmes marrëveshjeve të përbashkëta të nënshkruara me IAL-të shqiptare si një ofertë akademike e përbashkët. Në këtë kuadër do të forcohej “ndërkombëtarizimi në shtëpi” si alternativa më e qëndrueshme. Kjo nënkupton përmirësimin e ofertës akademike të brendshme, duke përfshirë elementë ndërkombëtarë siç janë: zgjerimi i programeve të studimit në gjuhë të huaja, veçanërisht në anglisht, që do të tërhiqte studentë ndërkombëtarë; krijimi i programeve të përbashkëta me universitetet e BE-së, ku studentët shqiptarë dhe ndërkombëtarë mund të përfitojnë njëkohësisht nga dy sisteme të ndryshme arsimore; modernizimi i infrastrukturës akademike dhe rritja e cilësisë së kërkimit shkencor në universitetet tona, duke përfshirë fonde për kërkime të avancuara dhe zhvillimin e teknologjive të reja; nxitja e lëvizshmërisë akademike duke lehtësuar shkëmbimin e studentëve dhe stafit akademik me universitetet e huaja, në vend që të sjellim universitetet e huaja në Shqipëri. Kjo qasje do të na lejojë të ndërtojmë një sistem të arsimit të lartë që është konkurrues, gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm.

Ky proces përfshin disa aspekte kryesore:

- **Bashkëpunimi ndërkombëtar:** Universitetet shqiptare po përpiqen të krijojnë partneritete me universitete të huaja për të mundësuar shkëmbimet e studentëve dhe stafit akademik, si dhe për të realizuar projekte kërkimore të përbashkëta.
- **Programet e përbashkëta:** Disa institucione shqiptare të arsimit të lartë kanë nisur programe të përbashkëta studimi me universitete ndërkombëtare, ku studentët mund të marrin diploma të njohura ndërkombëtarisht.
- **Akreditimi i programeve të përbashkëta / të dyfishta** është kompleks dhe i kushtueshëm (me kosto të lartë financiare dhe njerëzore). Njohja / njehsimi i akreditimeve nga agjenci




antare të ENQA do i reduktonte këto kosto, duke lehtësuar implementimin e programeve të përbashkëta.

- **Aplikimi për projekte të BE-së:** Universitetet në Shqipëri aplikojnë për fonde nga programet e Bashkimit Evropian si, Erasmus+, Horizon 2020 dhe të tjera, për të mbështetur mobilitetin e studentëve dhe të stafit, si dhe për të zhvilluar kapacitetet institucionale.
- **Promovimi i gjuhëve të huaja:** Shumë universitete ofrojnë programe studimi në gjuhë të huaja, kryesisht në anglisht, por nuk përjashtohen edhe gjuhët e tjera, për të tërhequr studentë ndërkombëtarë dhe për të përgatitur studentët vendës për tregun global të punës.
- **Konferenca dhe seminare ndërkombëtare:** Organizimi i konferencave dhe seminareve me pjesëmarrës ndërkombëtarë ndihmon në rritjen e ekspozimit të studentëve dhe personelit akademik ndaj praktikave dhe zhvillimeve më të fundit shkencore dhe akademike.

Objektivat kryesore në lidhje me ndërkombëtarizimin në arsimin e lartë janë:

- Hartimi i Planit të Integruar për ndërkombëtarizimin dhe profilizimin e universiteteve me qasje kombëtare dhe rajonale;
- Pjesëmarrja e IAL-ve në rrjetet ndërkombëtare të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;
- Lehtësimi i procedurave dhe ofrimi i incentivave për universitetet që bashkëpunojnë me partnerë ndërkombëtarë për ofrimin e diplomave të përbashkëta dhe të dyfishta dhe të delokalizuar;
- Krijimi i partneriteteve për hapjen e degëve apo kampuseve të universiteteve të huaja;
- Nxitja e IAL-ve për hapjen e programe të studimit në gjuhë të huaj dhe programe të mbështetjes së mësimin të gjuhës për studentë ndërkombëtarë.



Rritja dhe zgjerimi i burimeve të financimit, ku propozohet:

- Ngritja e një mekanizmi të ri financimi mbi bazë të performancës të orientuar në tre shtylla që përmbajnë; a) shtylla e parë të përmbajë financimi mbi bazën e kostove; grantit të mësimdhënies që përmban pagat e stafëve akademike dhe jo mësimore, mirëmbajtjen infrastrukurore, shërbimet mbështetëse dhe utilitetet etj; b) shtylla e dytë bazohet në zbatimin e Planit afatmësm të zhvillimit të universitetit të miratuar nga strukturat politikëbërës (përfshihen investime në infrastrukturë, mësimdhënie dhe kërkimi shkencor, zhvillim burimesh njerëzore; investime në sisteme informacioni; dhe strategji që rrisin impaktin e IAL-së në zhvillimin rajonal ose kombëtar) dhe c) shtylla e tretë që mbështet projekte që mbështesin inovacionin dhe prioritetet kombëtare ose rajonale përmes fondeve të posaçme të dedikuara për këtë kategori.
- Rritja e mëtejshme e autonomisë financiarë të IAL-ve, për rritjen e të ardhurave, bashkëpunimin mes të tretëve dhe vendosjen e niveleve të brendëshme të financimit.


## **Objektivi strategjik II.2: Fuqizimi i arsimit të lartë si katalizator i zhvillimit social, ekonomik dhe digjital drejt integritimit në BE**

**Objektivi specifik II.2.1:** Digjitalizimi i proceseve akademike e kërkimore në IAL drejt Universitetit 4.0.

**Objektivi specifik II.2.2:** Sigurimi i pavarësisë së ASCAL në përputhje me udhëzimet e standardet evropiane të cilësisë (ESG)

**Objektivi specifik II.2.3:** Përditësimi i mekanizmave të kontrollit të cilësisë për programet e studimit

Në epokën e revolucionit digjital, transformimi i arsimit të lartë përmes digjitalizimit është bërë një domosdoshmëri për të përmbushur kërkesat e shoqërisë moderne. Koncepti i Universitetit 4.0 përfshin integrimin e teknologjive të avancuara si inteligjenca artificiale (AI) dhe analiza e të dhënave të mëdha për të përmirësuar proceset akademike dhe kërkimore. Digjitalizimi i




mësimdhënies dhe mësimnxënies përfshin përdorimin e platformave të mësimit online, klasave virtuale dhe resurseve të edukimit elektronik (e-learning). Kjo mundëson një qasje më fleksibël dhe të personalizuar ndaj arsimit, ku studentët mund të ndjekin kurset sipas ritmit të tyre dhe të kenë akses në materialet mësimore nga çdo vend dhe në çdo kohë.

Përmirësimi i infrastrukturës teknologjike në arsimin e lartë në Shqipëri duhet të jetë në fokus të vazhdueshëm, me qëllim rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, duke integruar teknologjitë e reja në proceset mësimore, rritjen e kapacitetit për kërkime shkencore dhe inovacion, dhe zhvillimin e burimeve njerëzore për përvetësimin e teknologjive të reja. Për të realizuar këtë, duhet krijimi i platformave digjitale dhe laboratorëve të avancuar, përdorimin e “cloud computing” dhe “big data”, si dhe trajnimin e stafit akademik për përdorimin e teknologjive moderne.

Universitetet mund të zhvillojnë ose të adoptojnë platforma si Moodle, Blackboard, apo Canvas për të menaxhuar dhe shpërndarë kurset. Përdorimi i aplikacioneve si Zoom, Microsoft Teams apo Google Classroom për leksione dhe seminare interaktive në distancë. Krijimi i përmbajtjeve të pasura multimediale, duke përfshirë video-leksione, quize interaktive dhe simulime virtuale për të përforcuar mësimin praktik.

Teknologjitë digjitale ofrojnë mundësi të reja për zhvillimin e kërkimit shkencor, nga mbledhja e të dhënave, deri te publikimi dhe shpërndarja e rezultateve: Përdorimi i sensorëve dhe platformave të të dhënave të mëdha për të mbledhur dhe analizuar të dhëna në kohë reale nga eksperimente laboratorike dhe studime fushore; përdorimi i mjeteve të analizës së të dhënave dhe inteligjencës artificiale për të nxjerrë rezultate më të shpejta dhe më të sakta nga të dhënat e mbledhura. Përdorimi i platformave të hapura për publikime shkencore dhe rrjeteve sociale për shkencëtarët (si ResearchGate) për të shpërndarë dhe diskutuar gjetjet kërkimore me komunitetin global.


Digjitalizimi i proceseve administrative dhe shërbimeve studentore mund të përmirësojë ndjeshëm efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara: Integrimi i sistemeve të menaxhimit të të dhënave për regjistrimin e studentëve, notat, dhe pranimet; zhvillimi i aplikacioneve mobile



dhe portaleve online për të lehtësuar aksesin e studentëve në shërbime si bursa, këshillim karriere dhe mbështetje akademike; përdorimi i rrjeteve sociale dhe platformave të komunikimit për të përmirësuar komunikimin ndërmjet studentëve, stafit dhe administratës.

Digjitalizimi i proceseve akademike dhe kërkimore në IAL është një hap thelbësor drejt ndërtimit të Universitetit 4.0. Ky transformim do të ndihmojë në përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe kërkimit, duke ofruar një përvojë më të mirë për studentët dhe duke kontribuar në zhvillimin e shoqërisë. Për të arritur këtë vizion, universitetet duhet të investojnë në infrastrukturë teknologjike, të zhvillojnë aftësitë digjitale të personelit akademik dhe studentëve, dhe të krijojnë politika dhe strategji që mbështesin inovacionin dhe përmirësimin e vazhdueshëm.

Sfidat kryesore që dalin janë të lidhura me ndryshimet që kanë ndodhur gjatë këtyre viteve në IAL, ku ende ka programe mësimore të papërditësuara që nuk bazohen në rezultate të të nxënit. Qasja në literaturë të përditësuar në bibliotekat e institucioneve të arsimit të lartë mbetet një sfidë e rëndësishme, pavarësisht përpjekjeve individuale të pedagogëve, dhe ka nevojë për fonde shtesë nga qeveria, por edhe institucionet në drejtim të botimeve në gjuhën shqipe të literaturës së përditësuar. Ka një numër shumë të kufizuar të laboratorëve në IAL, dhe infrastruktura dhe pajisjet e përshtatshme janë të nevojshme për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe të kërkimit. Cilësia në arsimin e lartë arrihet nëpërmjet rritjes së cilësisë së kërkimit shkencor nga stafi akademik, përditësimit të programeve të studimit dhe përshtatjes me zhvillimet e reja dhe nevojat reale të tregut të punës në vend, modernizimit të infrastrukturës akademike dhe aplikimit të standardeve të larta të vlerësimit institucional dhe të programeve të studimit. Institucionet shqiptare të arsimit të lartë ofrojnë mbi 1,400 programe studimi që, nga aspekti strukturor, ndjekin praktikën e vendeve anëtare të Procesit të Bolonjës. Si të tilla, këto programe kanë nevojë për rishikim të vazhdueshëm dhe përshtatje me nevojat e kohës. Ndërkaq, infrastrukturën akademike e përbëjnë godinat, pajisjet, kabinetet, laboratorët e bibliotekat që janë në shërbim të personelit akademik dhe të studentëve. Modernizimi i kësaj infrastrukture ndikon edhe në cilësinë e realizimit të programeve të studimit.






Ndryshimet në sistemin e sigurimit të cilësisë në Shqipëri këto vitet e fundit kanë përfshirë disa aspekte kryesore, duke përfshirë legjislacionin, institucionet dhe proceset e sigurimit të cilësisë. Proceset e akreditimit janë bërë të institucionalizuara dhe të standardizuara. Institucionet e arsimit të lartë kalojnë përmes një vlerësimi të detajuar të cilësisë së mësimdhënies, kërkimit dhe infrastrukturës, mbështetjes së studentëve etj. Arsimi i lartë në Shqipëria ka përfituar nga përvojat ndërkombëtare dhe ka përfshirë ekspertë ndërkombëtarë në proceset e vlerësimit dhe akreditimit, për të siguruar objektivitet dhe për të ndjekur praktikat më të mira. Ka pasur një fokus më të madh në rritjen e transparencës dhe aksesit në informacion për studentët dhe publikun e gjerë. Publikimi i raporteve të akreditimit dhe të dhënave të performancës është bërë më i zakonshëm. Shqipëria ka përmirësuar kuadrin ligjor për arsimin e lartë dhe sigurimin e cilësisë, për të përputhur standardet me ato të Bashkimit Evropian. Ligji për Arsimin e Lartë dhe aktet nënligjore për sigurimin e cilësisë janë përditësuar për të rritur transparencën dhe përgjegjësinë, por mbeten akoma disa objektiva të cilat duhe të përmirësohen për të arritur objektivat e kërkuar.

Objektivat kryesore në lidhje me sigurimin e cilësisë në sistemin e arsimit të lartë janë:

- Rritja e ndërgjegjësimi për rëndësinë e sigurimit të cilësisë dhe promovimi i kulturës së përmirësimit të vazhdueshëm të saj, përmes mekanizmave të brendshëm të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë;
- Rritja e transparencës dhe llogaridhënies në institucionet e arsimit të lartë duke ofruar informacion të qartë dhe të aksesueshëm për performancën dhe cilësinë e tyre;
- Ndërtimi dhe rritja e besimit midis palëve të interesuara, duke përfshirë studentët, punëdhënësit, grupet e interesit në proceset e sigurimit të cilësisë dhe integritetin e arsimit të lartë;
- Amendimi i akteve ligjore e nënligjore në fuqi për të siguruar pavarësinë e ASCAL dhe Bordit të Akreditimit në përputhje me udhëzimet e standardet evropiane të cilësisë (ESG);
- Përmirësimi i mëtejshëm i standardeve të cilësisë me anë të të cilave vlerësohet cilësia e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit;



- Amendimi i akteve nënligjore në fuqi për rritjen dhe përfshirjen efikase të anëtarëve nga grupet e interesit dhe studentëve në proceset e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë;
- Rritja e pjesëmarrjes së diasporës akademike në proceset e vlerësimit të jashtëm të brendshëm të cilësisë;
- Procedura së apelimit të procesit të vlerësimit të jashtëm dhe vendimeve të Bordit të Akreditimit, në përputhje me udhëzimet e standardet evropiane të cilësisë (ESG);
- Aplikimi për akreditimin e programeve të studimit në grup. Kjo gjë do të lehtësonte ngarkesën e burimeve njërzore të institucionit, të Agjencisë dhe të Bordit, si dhe do të ulte tarifën e akreditimit për institucionin.

Sa më sipër përmirësime synojnë të rrisin cilësinë e arsimit në Shqipëri, të përmirësojnë konkurrencën e institucioneve shqiptare të arsimit të lartë dhe të sigurojnë që studentët të marrin një arsimim të cilësisë së lartë, që përputhet me standardet ndërkombëtar




## Referencat e përdorura


- Amendim Udhëzimi Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) Nr. 36, datë 23.11.2018 Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin Nr. 29, datë 10.9.2018, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë” (Fletore Zyrtare Nr. 198 Viti 2018 Faqe 15307) <https://qbz.gov.al/eli/udhezim/2018/11/23/36/f4d9b9f6-f7bb-414e-8bb1-1f92f7dc3958>
- Amendim Udhëzimi Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) Nr. 24, datë 21.10.2019 Për një ndryshim në Udhëzimin Nr. 5, datë 19.2.2018, “Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë” (Fletore Zyrtare Nr. 145 Viti 2019 Faqe 12037) <https://qbz.gov.al/eli/udhezim/2019/10/21/24/3387e662-109f-411e-850d-5f7d80625805>
- Amendim VKM Nr 431 datë 22.06.2022 Për disa ndryshime në VKM Nr 75 datë 12.02.2018 Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor (Fletore Zyrtare Nr 94, Viti 2022, Faqe 11956) <https://qbz.gov.al/eli/fz/2022/94/94a88b3e-ef55-4b13-9752-b97539966910> ;
- Amendimi VKM Nr 562, datë 31.7.2019 Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr 109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë- ASCAL e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë” (Fletore Zyrtare Nr. 114 Viti 2019 Faqe 8569) <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2019/07/31/562/f2fe570e-4ac7-4396-9530-45ceec975675>
- Banka Boterore, Maj 2024-Arsimi terciar i Shqipërisë: Drejt një udhëzuesi transformimi - Një vlerësim i shpejtë.  
<https://ëëë.asc.al/sq/lista-e-ial/institucionet-jo-publike> - Lista e IAL (Institucionet e Arsimit të Lartë) jo publike në RSH (26)
- Raport i Sondazhit Kombëtar i Studentëve 2022 - ASCAL  
<https://www.asc.al/sq/lista-e-ial/programet-e-studimit> - Lista e plotë e programeve të studimit që janë akredituar (1,288) në IAL publike e jo-publike  
<https://www.rash.al/sq/software/kombetare/u-albania/> - Portali U-Albania  
[https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Raport\\_Final\\_Ministria\\_Arsimit.pdf](https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Raport_Final_Ministria_Arsimit.pdf) - Raporti Përfundimtar për Reformimin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Korrik 2014, hartuar nga Komisioni i Lartë për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor  
[https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Raport\\_Ministria\\_Arsimit.pdf](https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Raport_Ministria_Arsimit.pdf) - Raporti i I-rë për Reformimin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Janar-Prill 2014, hartuar nga Komisioni i Lartë për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor  
<https://ascal.al/sq/informacione/lajme/lista-e-plote-e-programeve-te-studimit-te-cilat-jane-ne-proces-akreditimi> - Lista e plotë e programeve të studimit që janë aktualisht në process akreditimi (255) të IAL publike e jo-publike  
[https://www.asc.al/sq/?option=com\\_k2&view=item&layout=item&id=6&Itemid=677](https://www.asc.al/sq/?option=com_k2&view=item&layout=item&id=6&Itemid=677) Lista e IAL (Institucionet e Arsimit të Lartë) publike në RSH (14)  
<https://qbz.gov.al/eli/ligj/2015/07/22/80/e74c8fac-eac9-44fd-bbb3-30e98b337dc8>  
<https://qbz.gov.al/eli/udhezim/2017/12/29/27/ab391be5-b637-4c3c-9286-b25c992945f4>;  
<https://qbz.gov.al/eli/udhezim/2018/09/10/29/c122f483-c75d-4317-b142-81f848445f9a>  
<https://qbz.gov.al/eli/vendim/2018/09/11/531/eda1cff9-4607-43b6-b4c2-f482c6c98be9>
- Ligj Nr 80/2015 datë 22.07.2015 Për arsimin të lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë (Fletore Zyrtare Nr. 164 Viti 2015 Faqe 11449)
- Ligj Nr. 117/2014 datë 11.9.2014 Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në Programin “Erasmus +”, (2014-2020) Programi i BE-së për Arsimin, Trajnimin, Rininë dhe Sportin (Fletore Zyrtare Nr. 153 Viti 2014 Faqe 7961) [Link https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/09/11/117/e44f1730-45fd-4855-9ee9-dbc4ddb91da0](https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/09/11/117/e44f1730-45fd-4855-9ee9-dbc4ddb91da0)
- Ligj Nr. 25/2016 datë 10.3.2016 Për ratifikimin e Marrëveshjes në lidhje me Programin e Shkëmbimit të Studimeve Universitare në Evropën Qendrore (CEEPUS III) (Fletore Zyrtare Nr. 49 Viti 2016 Faqe 3243) <https://qbz.gov.al/eli/ligj/2016/03/10/25/a9c1a029-3014-4702-a0ac-1aa7ef18a1b8>



- Ligj Nr. 8834, datë 22.11.2001 Për ratifikimin e “Konventës për njohjen e Kualifikimeve të Arsimit të Lartë në Europë” (Lisbonë, 1997) (Fletore Zyrtare Nr. 56, Viti 2001 Faqe 177) <https://qbz.gov.al/eli/ligi/2001/11/22/8834/998301e9-23bb-4955-823a-6d98f09e66f1>
- Ligj Nr. 93/2019 datë 18.12.2019 Për ratifikimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (Këshilli i Ministrave) dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Programin e Shkëmbimit Akademik “Fulbright” ( Fletore Zyrtare Nr 185, Viti 2019, Faqe 15131)
- OECD – “Konkurueshmeria e Ballkanit Perendimor per vitin 2024 (Competitiveness Outlook 2024)
- Russell King, Ilir Gëdeshi “Albanian Students Abroad: A Potential Brain Drain?” November 2023
- Udhëzim i Përbashkët Nr 1242 i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë datë 14.08.2019 Për miratimin e listës së shërbimeve që do të ofrohen nga strukturat vartëse të Ministrisë së Mbrojtjes, me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit (Fletore Zyrtare Nr 132, Viti 2019, Faqe 11192) <https://qbz.gov.al/eli/fz/2019/132/2eb4e7d5-20ad-4cbc-b023-62247fe5f490>
- Telhaj, Shqiponja, Iraj Hashi, Indrit Hoxha, Drian Nace dhe Darinka Piqani: Raport mbi Ecurine e Cilesise se Arsimit te Larte ne Shqiperi, Bordi I Akreditimit, Tetor 2024.
- Udhëzim i Përbashkët Nr 440 i Ministrisë së Turizmit e Mjedisit dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit e Rinisë datë 11.09.2019 Për përcaktimin e shërbimeve të ofruara me çmime të reduktuara përmes përdorimit të Kartës së Studentit në fushën e turizmit dhe mjedisit Fletore Zyrtare Nr 131 Viti 2019, Faqe 11158) **Link** <https://qbz.gov.al/eli/fz/2019/131/8a7c6ea4-304a-48e1-95ba-3cfc4153452c> ;
- Udhëzim i përbashkët i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) dhe i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë (MFE) Nr.20, datë 20.9.2019 Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor (Fletore Zyrtare Nr. 141 Viti 2019 Faqe 11688) <https://qbz.gov.al/eli/udhezim/2019/09/20/20/54afbc29-94ee-4cf2-a9fa-a4ab655cc839>
- Udhëzim i Ministrit të Arsimit dhe Sportit (MAS) Nr. 21, datë 15.10.2021 Për kriteret dhe procedurat për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar (Fletore Zyrtare Nr. 165 Viti 2021 Faqe 15077) <https://qbz.gov.al/eli/udhezim/2021/10/15/21/1dc4136c-2169-4bd7-8e09-cacad965caab>
- Udhëzim i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) Nr. 5, datë 19.02.2018 Për përcaktimin e elementeve përbërëse të Raportimit Vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë (Fletore Zyrtare Nr. 25 Viti 2018 Faqe 1971) <https://qbz.gov.al/eli/udhezim/2018/02/19/5/fd023915-6013-4a34-b351-a99dd2509177>
- Udhëzim i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) Nr. 27, datë 29.12.2017 Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë (Fletore Zyrtare Nr. 242 Viti 2017 Faqe 13367)
- Udhëzim i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) Nr. 37, datë 4.12.2018 Për një ndryshim në Udhëzimin Nr. 29, datë 10.9.2018, “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, të ndryshuar (Fletore Zyrtare Nr. 179 Viti 2018 Faqe 12266) <https://qbz.gov.al/eli/udhezim/2018/12/04/37/b4c325db-4fe6-4811-8fd7-748ce932b43f>
- Udhëzim i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) Nr. 4, datë 16.2.2018 Për zbatimin e Programit të Shkëmbimit të Studimeve Universitare në Evropën Qendrore CEEPUS III në Republikën e Shqipërisë (Fletore Zyrtare Nr. 24 Viti 2018 Faqe 1967) <https://qbz.gov.al/eli/udhezim/2018/02/16/4/d3a66d61-489c-4b41-ae4b-347eed2b283>
- Udhëzim Nr 14 i Ministrisë së Arsimit e Sportit datë 17.05.2019 Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përgatitjen dhe lëshimin e Kartës së Studentit (Fletore Zyrtare Nr 87 Viti 2019. Faqe 1865) <https://qbz.gov.al/eli/fz/2019/87/6ad2ba68-58be-4b2a-9e03-788bbcd1fa3a>;
- Udhëzim Nr 3 i Ministrisë së Arsimit e Sportit datë 13.02.2024 Për një ndryshim në Udhëzimin Nr 14 I Ministrisë së Arsimit e Sportit datë 17.05.2019 Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përgatitjen dhe lëshimin e Kartës së Studentit (Fletore Zyrtare Nr 33 Viti 2024 Faqe 3967) <https://qbz.gov.al/eli/fz/2024/33/838399e9-1edf-40f8-9155-a3a3f4a1029b>;
- Udhëzimi i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) Nr. 29, datë 10.9.2018 Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë (Fletore Zyrtare Nr. 133 Viti 2018 Faqe 9146)
- Urdhër i përbashkët i Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë dhe i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr. 54, datë 30.1.2019 Për miratimin e formatit të publikimit të të dhënave të detajuara mbi të ardhurat dhe shpenzimet financiare të institucioneve publike të arsimit të lartë (Fletore Zyrtare Nr. 9 Viti 2019 Faqe 261) **Link** <https://qbz.gov.al/eli/urdher/2019/01/30/54/54acc865-677e-4787-9133-251df2f63e58>



- VKM Nr 183 datë 02.03.2006 Për çmimin, formën, përmbajtjen, elementet e sigurisë dhe procedurat për pajisjen me Kartën e Studentit (Fletore Zyrtare Nr 32, Viti 2006. Faqe 2345) <https://qbz.gov.al/eli/fz/2006/32/a84de707-468f-4995-a0bb-fdf27c2d3a43>
- VKM Nr 531, datë 11.9.2018 Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë (Fletore Zyrtare Nr. 135 Viti 2018 Faqe 9214) <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2018/09/11/531/eda1cff9-4607-43b6-b4c2-f482c6c98be9>
- VKM Nr 781, datë 26.12.2018 Për garantimin e transparencës në institucionet publike të arsimit të lartë (Fletore Zyrtare Nr. 189 Viti 2018 Faqe 14968) <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2018/12/26/781/43e1cc67-986e-4827-8f68-230567d3ae82>
- VKM Nr .109, datë 15.2.2017 Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë (Fletore Zyrtare Nr. 33 Viti 2017 Faqe 2085) <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2017/02/15/109/4fd69c7a-2001-4975-b70b-f80bc76a204f>
- VKM Nr 165, datë 21.3.2018 Për metodologjinë e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë (Departamenteve) të institucioneve të arsimit të lartë (Fletore Zyrtare Nr. 41 Viti 2018 Faqe 2538) <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2018/03/21/165/4589331d-e683-4206-8c4c-531be2d425bd>
- VKM Nr 226 datë 17.04.2019 Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të Kartës së Studentit (Fletore Zyrtare Nr 57 Viti 2019. Faqe 4314) **Link** <https://qbz.gov.al/eli/fz/2019/57/440e1f16-1408-402e-a630-5d1bcd74604e> ;
- VKM Nr 395 datë 24.05.2015 Për miratimin e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në administratën publike dhe institucionet e tjera shtetërore (Fletore Zyrtare Nr 80, Viti 2015, Faqe 3565) <https://qbz.gov.al/eli/fz/2015/80/ac1fd0fb-7407-4491-9bf9-013c4bca732b>
- VKM Nr 397, datë 3.5.2017 Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL) (Fletore Zyrtare Nr. 106 Viti 2017 Faqe 5805) <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2017/05/03/397/637c0d53-bce7-422a-861d-030b4a954a01>
- VKM Nr 607, datë 31.8.2016 Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) (Fletore Zyrtare Nr. 166 Viti 2016 Faqe 20205) <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2016/08/31/607/bbb6cc7d-d441-4439-a1d1-85e908124435>
- VKM Nr 641, datë 29.7.2020 Për përcaktimin e Autoritetit Kontraktor për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik për projektet “Ndërtim i Kampusit të Ri të Universitetit të Tiranës”, “Ndërtim i godinave të Universitetit të Arteve të Tiranës” dhe “Ndërtim i Korpusit të Policisë së Shtetit, Policisë Shkencore dhe Akademisë së Sigurisë” (Fletore Zyrtare Nr. 155 Viti 2020 Faqe 9749) <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/07/29/641/05382db7-0978-454f-95a2-bbe7bca7e6a1>
- VKM Nr 75 datë 12.02.2018 Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor (Fletore Zyrtare Nr 22, Viti 2018, Faqe 1369) <https://qbz.gov.al/eli/fz/2018/22/fef6067b-f736-4800-b6e5-d4c61ec3889f>
- VKM Nr 903 datë 22.12.2016 Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga Fondi i Mbështetjes Studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë (Fletore Zyrtare Nr 254, Viti 2016, Faqe 25473) <https://qbz.gov.al/eli/fz/2016/254/73066db5-af09-4b71-a3de-35deed5b5ff6>



DOKUMENTI  
I POLITIKAVE  
**TË ARSIMIT**  
**TË LARTË**



[www.arsimi.gov.al](http://www.arsimi.gov.al)

